



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 2
02.05.2017

NR. VENDIMI 16
03.05.2018

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, e përbërë prej gjyqtarëve:

K/séance gjyqësore	Flora	Hajredinaj
Anëtar “	Klodian	Kurushi
Anëtare “	Iliriana	Olldashi

Asistuar prej sekretares Fjoralba Kola, sot më dt.03.05.2018, përfundoi së shqyrtuari në seancë gjyqësore, publike, çështjen civile me nr.2/20 që u përket palëve:

PADITËS: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë përfaqësuar në gjykim, nga prokurore Sonila Muhametaj.

TË PADITUR:

1. F. K., i biri i i biri i S. dhe i Sh.i datëlindjes xxxx, lindur në xxxx dhe banues në xxxx, me shtetësi shqiptare, i divorcuar dhe me xxxx fëmijë, me zotësi të plotë juridie dhe për të vepruar, përfaqësuar në gjykim nga av.A. V. sipas prokurës së posaçme datë xxxx.

2. M. Ç., e bija e M. dhe Dh., e datëlindjes xxxx, lindur dhe banuese në xxxx, me arsim të xxxx, e divorcuar dhe me xxx fëmijë, e padënuar më parë nga gjykata, identifikuar me pasaportë biometrike me numër personal xxxx dhe nr.pasaporte xxxx datë lëshimi xxxx, e pranishme në gjykim, përfaqësuar nga av. Th. S. me licensë profesionale nr.xxx dhe nr.nipti xxxx, Dhoma e Avokatisë, xxxx dhe E. D., Dhoma e Avokatisë, xxxx, zgjedhur me deklaram në seancë gjyqësore

3. F. K., i biri i F. dhe M., i datëlindjes xxxx, lindur në xxxx dhe banues në xxxx-xxxx, me arsim të xxxx, me gjendje civile xxxx, identifikohet me pasaportë biometrike me nr.personal xxxx, dhe nr.pasaporte xxxx, datë lëshimi xxxx, përfaqësuar në gjykim nga av.A. Ç. sipas prokurës të përgjithshme nr.xxx rep., dhe nr.kol., xxxx, datë xxxx, me licensë profesionale nr.xxx, dhe nr.nipti xxxx, anëtare e Dhomës së Avokatisë, xxxx.

PALË TË TRETA:

1 R. P., e bija e S. dhe D., e datëlindjes xxxx, lindur në xxxx, banuese në xxxx, e martuar dhe me x fëmije, me arsim xxx identifikohet me kartë elektronike ID, me numër personal nr.xxxx, datë lëshimi xxxx, e përfaqësuar nga av.A. Ç..

2 A. M., identifikohet me kartë elektronike ID nr.personal, xxxx, datë lëshimi xxxx, përfaqësuar në gjykim nga av. E. S., sipas prokurës së posaçme nr. xxx rep., dhe nr. xxx kol., datë xxxx.

3 E. M., përfaqësuar nga av.E. S. sipas prokurës së posaçme, nr.xxx rep., dhe nr.xxx kol., datë xxxx.

4 Shoqëria “xxxx”, sh.p.k përfaqësuar nga av.A. Ç., të zgjedhur me dekaltrim në seancë gjyqësore si edhe me prokurën e posaçme nr.xxx rep., dhe nr.xxx kol., datë xxxx.

ME OBJEKT: 1.Konfiskimin e pasurive të paluajftëshme si më poshtë:

1. Pasuria me vendndodhje zona kadastrale xxxx, nr.xxxx, vol.xx fq.xx, truall me sipërfaqe xxxx m2, ndërtesë xxxx m2, në emër të të paditurës M. C..
2. Pasuria me vendndodhje zona kadastrale xxx nr.xxx me nr.regjistri hipotekor xxx datë xxxx, pyll me sipërfaqe totale xxxx m2, në emër të të paditurës M. Ç. dhe F. A. dhe L. L. (M. Ç. nga kjo pasuri zotëron xxxx m2).
3. Pasuria nr. xxx, me vendndodhje Zona Kadastrale xxxx, me nr.regjistri hipotekor xx datë xxxx, pyll me sipërfaqe xxxx m2, në emër të të paditurës M. Ç..
4. Pasuria me vendndodhje zona kadastrale xxx, nr.xxxx, me nr.regjistri hipotekor xx datë xxxx, pyll me sipërfaqe xxxx m2, në emër të të paditurës M. Ç..
5. Pasuria me vendndodhje zona kadastrale xxxx, nr.xxxx, me nr.regjistri hipotekor xx datë xxxx, pyll me sipërfaqe xxxx m2, në emër të të paditurës M. C..
6. Pasuria me vendndodhje zona kadastrale xxxx, nr.xxxx, me nr.regjistri hipotekor xx datë xxxx, tokë pa frut me sipërfaqe xxxx m2, në emër të të paditurës M. Ç..
7. Pasuria me vendndodhje zona kadastrale xxxx, nr.xxxx, me nr.regjistri hipotekor xxxx datë xxxx, tokë pa frut, me sipërfaqe xxxx m2, në emër të të paditurës M. Ç..
8. Pasuria me vendndodhje zona kadastrale xxxx, nr.xxxx, me nr.regjistri hipotekor xxx datë xxxx, tokë pa frut, me sipërfaqe xxxx m2, në emër të të paditurës M. Ç..
9. Pasuria me vendndodhje zona kadastrale xxxx, nr.xxxx, me nr.regjistri hipotekor xxx datë xxxx, tokë pa frut, me sipërfaqe xxxx m2, në emër të të paditurës M. Ç..
10. Pasuria me vndndodhje zona kadastrale xxxx nr.xxxx, me nr.regjistri hipotekor xxx datë xxxx, tokë pa frut, me sipërfaqe xxxx m2, në emër të të paditurës M. Ç..
11. Pasuria me vendndodhje zona kadastrale xxxx, nr.xxxx, me nr.regjistri hipotekor xxx datë xxxx, tokë pa frut me sipërfaqe xxxx m2, në emër të të paditurës M. Ç..
12. Pasuria me vendndodhje zona kadastrale xxxx, nr.xxxx, me nr.regjistri hipotekor xx datë xxxx, tokë arë, me sipërfaqe xxxx m2, në emër të të paditurës M. Ç..
13. Pasuria me vendndodhje zona kadastrale xxxx nr.xxxx, me nr.regjistri hipotekor xxxx datë xxxx, tokë pa frut, me sipërfaqe xxxx m2, në emër të të paditurës M. Ç..

14. Pasuria me vendndodhje zona kadastrale xxxx, nr.xxxx, me nr.regjistri hipotekor xxx datë xxxx, pyll, me sipërfaqe xxxx m2, në emër të të paditurës M. Ç..
15. Pasuria me vendndodhje zona kadastrale xxxx, nr.xxxx, me nr.regjistri hipotekor xxx datë xxxx, arë, me sipërfaqe xxxx m2, në emër të të paditurës M. Ç..
16. Pasuria me vendndodhje zona kadastrale xxxx, nr.xxxx, me nr.regjistri hipotekor xxx datë xxxx, arë, me sipërfaqe xxxx m2, në emër të të paditurës M. Ç..
17. Pasuria me vendndodhje zona kadastrale xxxx, nr.xxxx, me nr.regjistri hipotekor xxxx datë xxxx, tokë arë, me sipërfaqe xxxx m2, në emër të të paditurës M. Ç..
18. Pasuria me vendndodhje zona kadastrale xxxx, nr.xxxx, me nr.regjistri hipotekor xx datë xxxx, tokë pyll, me sipërfaqe xxxx m2, në emër të të paditurës M. Ç..
19. Pasuria me vendndodhje zona kadastrale xxxx nr.xxx, me nr.regjistri hipotekor xx datë xxxx, tokë pyll me sipërfaqe xxxx m2, në emër të të paditurës M. Ç..
20. Pasuria me vendndodhje zona kadastrale xxxx, nr.xxx, me nr.regjistri hipotekor xxx datë xxxx, tokë pa frut, me sipërfaqe xxxx m2, në emër të të paditurës M. Ç..
21. Pasuria me vendndodhje zona kadastrale xxxx, nr.xxxx, me nr.regjistri hipotekor xxxx datë xxxx, tokë pa frut, me sipërfaqe xxxx m2, në emër të të paditurës M. Ç..
22. Pasuria me vendndodhje zona kadastrale xxxx, nr.xxxx me nr.regjistri hipotekor xxxx date xxxx, tokë inproduktive, me sipërfaqe xxxx m2, në emër të të paditurës M. Ç..

II. Konfiskimin e pasurive të luajtshme si më poshtë vijon:

1. Asetet e Shoqërisë “xxxx”, sh.p.k me nr.nipti xxxx, si më poshtë:
linjë prodhimi x(xxxx); pirun x(xxx); pompa suvatimi x(xxx); pompa suvatimi x(xxx); pompa suvatimi x (xxx); mjet transporti ,x (xxx) copë; mjet trasportit x , x(xxxx) copë; automjet xxxx x(xxx), paisje zyresh x(xxxx), tavolina x(xxx), karrike x(xxx), paisje kompjuterike x(xxx), kasë fiskale x(xxx), të tjera x(xxx).
2. Asetet e Shoqërinë “xxxx”, sh.p.k, me nr.nipti xxxx, si më poshtë:
kosha metalik x (xxxx); autobus x (xxx) copë; autobus xxx (xxx) copë; autobus xx (xxx) copë, autopbuz xxx (xxx) cope, autobus xxx (xxx) copë.
3. Asetet e në shoqërisë “xxxx”, sh.p.k me nr.nipti xxxx, (pjesë takuese të paditurit F. K.), si më poshtë:
bllokues makinash x(x); mjet transporti karrotrec x (xxx), system ngrohje kondicioner x (xxx), kompjuter x (xxx); aparat fotografik x (xxx); kasë elektronike x (xxx); aparat fotografik x (xxx); aparat fotografik x (xxx), mjete i marrë me qira financiare xxxx.
4. Shumat e llogarive bankare të shoqërive “xxxx”, “xxxx” dhe “ xxxx si më poshtë:
-në llogarinë nr.xxxx xxxx Bank (xxxx) shuma xxxx leke; në llogarinë nr.xxxx xxxx Bank (xxxx), shuma xxxx euro; në llogarinë nr.xxxx xxxx Bank (xxxx) shuma xxxx lekë; në llogarinë nr. xxxx xxxx Bank (xxxx) shuma
-xxxx euro; në llogarinë nr. xxxx xxxx Bank (xxxx), shuma -xxxx lekë; në llogarinë

nr.xxxx xxxx Bank (Çitadela), shuma -xxxx euro; në llogarinë nr.xxxx xxxx (xxxx), shuma xxxx lekë; në llogarinë nr.xxxx xxxx Bank (xxxx), shuma xxxx euro; në llogaria nr.xxxx xxxx Bank (xxxx), shuma xxxx lekë; në llogarinë nr.xxxx xxxx Bank (xxxx) shuma -xxxx lekë; në llogarinë nr. xxxx xxxx bank (xxxx), shuma xxx lekë; në llogarinë nr.xxxxxx xxxx (xxxx) shuma x lekë; në llogarinë nr.xxxx xxxx Bank (xxxx), shuma -xxxx lekë; në llogarinë nr.xxxx xxxx (xxxx), shuma xx lekë; në llogarinë nr.xxxx xxxx Bank (xxxx), shuma xxxx lekë; në llogarinë nr.xxxx xxxx (xxxx), shuma xxxx leke.

BAZA LIGJORE: Nenet 21, 23, 24 të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 “Per parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Gjykata pasi shqyrtoi aktet dhe:

-dëgjoi përfaqësuesin e paditësit, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë për Krime të Rënda, Tiranë, prokuroren Suela Muhametaj që kërkoi:

1. Konfiskimin e të gjitha pasurive si më sipër.

2. Për Administrimin dhe përdorimin e pasurive të luajtshme dhe paluatshme të ngarkohet administratori i Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë, B. B..

3.Për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet Zyra e Përmbartimit xxxx.

-dëgjoi përfaqësuesin e të paditurit F. K., avokatin A. V. i cili kërkoi rrëzimin e kërkesës për konfiskimin e pasurive;

-dëgjoi personalisht të paditurin F. K. i cili u shpreh se është dakort me diskutimin e mbrojtësit të tij;

-dëgjoi përfaqësuesin e të paditurës M. Ç., avokatin E. D., i cili kërkoi rrëzimin e kërkesës për konfiskimin e pasurive;

-dëgjoi personalisht të paditurën M. Ç. e cila kërkoi rrëzimin e kërkesës për konfiskimin e pasurive;

-dëgjoi përfaqësuesin e të paditurit F. K., avokatin A. Ç. e cila kërkoi rrëzimin e kërkesës për konfiskim të pasurive;

-dëgjoi përfaqësuesin e të palës së tretë R. P. avokatin A. Ç., e cila kërkoi rrëzimin e kërkesës për konfiskimin e pasurive;

-dëgjoi personalisht palen e tretë R. P., e cila kërkoi rrëzimin e kërkesës për konfiskimin e pasurive;

-dëgjoi përfaqësuesin e të palës së tretë E. M., avokatin E. S., i cili kërkoi rrëzimin e kërkesës për konfiskimin e pasurive;

-dëgjoj përfaqësuesin e të pales se trete A. M., avokatin E. S., i cili kërkoi rrëzimin e kërkesës për konfiskimin e pasurive;

-dëgjoj përfaqësuesin e të pales se trete shoqërinë “xxxx” sh.p.k, avokaten A. Ç., e cila kërkoi rrëzimin e kërkesës për konfiskimin e pasurive;

-si edhe pasi bisedoi çështjen në tërësi të saj,

VËREN SE:

I. Më datë xxxx është regjistruar kërkesa e paditësit, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, kundër të paditurve F. K., M. Ç. dhe F. K. me objekt, konfiskim të pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme, të cituara në pjesën hyrëse të këtij vendimi, duke u bazuar në ligjin nr.10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, para ndryshimeve të pësuara me ligjin nr.70/2017, (më poshtë ligji nr.10192/2009) gjykim i cili përfundoi më datë xxxx.

Që në fillim të këtij arsyetimi, gjykata çmon të evidentojë se ndryshe nga sa parashtrio përfaqësuesja e palës së paditur F. K. dhe, e palëve të treta R. P. dhe shoqëria “xxxx” sh.p.k, av.A. Ç., nga ana e gjykatës janë bërë përpjekjet maksimale për përfundimin e gjykimit të çështjes brenda afatit një vjeçar, siç parashikon neni 23/2 i ligjit nr.10192/2009, siç edhe ka ndodhur. Gjykata sqaron dhe, shpreh qëndrimin e saj se edhe nëse gjykimi i kësaj kërkesë komplekse, nuk do të ishte bërë e mundur të përfundonte brenda afatit që parashikon dipozita e sipërcituar, nuk passjell pasojën e rrëzimit të kërkesës për konfiskim dhe, heqjen e masës parandaluese atë të sekuestrimit ndaj pasurive, objekt konfiskimi, siç edhe u pretendua, pretendim të cilin gjykata e konsideron të pambështur në ligj.

Së fundmi, në lidhje me këtë këtë pretendim, gjykata sjell në vëmendje faktin se seanca gjyqësore e datës xxxx, e cila vijoi tej orarit zyrtar, u ndërpre, për të vijuar të nesërmen e ditës së punës datë xxxx ku u shpall edhe, vendimi përfundimtar. Mbi pretendimet përfundimtare të palëve, janë zhvilluar xx (xxxx) seanca gjyqësore, prej të cilave gjykata evidenton faktin se seanca gjyqësore e datës xxxx, është shtyrë për mosparaqitje të palës paditëse, Prokuroria për Krime të Rënda dhe, seancat gjyqësore datë xxxx; xxxx dhe xxxx janë shtyrë për shkak se nga ana e palës paditëse nuk u përmbush detyrimi ligjor i saj për paraqitjen dhe depozitimin e adresave të sakta të palëve në proces. Për mosparaqitje në seancë gjyqësore po të palës paditëse, janë shtyrë edhe, seancat gjyqësore të datave xxxx; xxxx dhe xxxx, xxxx, xxxx. Gjithashtu, me kërkesë të palës paditëse edhe, pasi gjykata u dha palëve mundësinë reale për tu njohur me aktin e ekspertimit kontabël dhe vlerësues, të kryer gjatë gjykimit të çështjes, është shtyrë për të njëjtin shkak edhe, seancë gjyqësore e datës xxxx. Po është me kërkesë të palës paditëse, gjykata ka pranuar riçeljen e shqyrtimit gjyqësor më datë xxxx riçelje e cila passolli vijimin e gjykimit edhe për disa ditë, gjithsesi brenda afatit të parashikuar në nenin 23 të ligjit të posaçëm.

II). Në lidhje me legjitimin e palëve, Gjykata referuar subjekteve të zbatimit të ligjit të sipërcituar, sqaron se fillimisht padia është ngritur kundër të paditurve F. K., M. Ç. dhe F. K.. Në kushtet që nga verifikimet e bëra, po mbi aktet e sjella

nga pala paditëse, Prokuroria prane Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, u konstatua nga gjykata se disa prej pasurive objekt konfiskimi u përkisnin personave të tjerë si edhe, në kushtet që paditesi i qëndroi kërkesës për konfiskim edhe të atyre pasurive, bazuar në nenin 22/3 të ligjit nr. 10192/2009 vendosi të thërrasë me cilësinë e personit të tretë në këtë gjykim shoqërinë “xxxx” sh.p.k, në lidhje me pasurinë nr.xxxx zona kadastrale xxxx me nr.hipotekor xxx, dt.xxxx dhe pasurinë nr.xxxx zona kadastrale xxxx me nr.hipotekor xxxx, datë xxxx, pasurinë nr.xxx zona kadastrale xxx me nr.hipotekor xxx, datë xxxx, shtetasen R. P. për pasuritë me nr.xxxx zona kadastrale xxx me nr.hipotekor xxx, datë xxxx, pasurinë nr. xxx zona kadastrale xxxx, me nr.hipotekor xxx, datë xxxx dhe pasurinë nr. xxxx zona kadastrale xxxx, me nr.hipotekor xxx, datë xxxx pasurinë me nr.xxxx, shtetasit A. M. dhe E. M. ne lidhje me pasuritë nr.xxxx zona kadastrale xxxx me nr.hipotekor xx, datë xxxx dhe, nr.xxx zona kadastrale xxxx, me nr.hipotekor xx, datë xxxx.

Gjykata, çmon të evidentojë në këtë vendim edhe faktin se gjatë gjykimit të çështjes, pas legjitimit të palëve sipas padisë, gjykata mori në shqyrtim edhe një kërkesë te depozituar ne k/sekretari, të shoqërisë “xxxx” “xxxx” sh.p.k, me seli në rrugën “xxxx”, nr.xx, xxxx, me administrator shtetasin T. H., për ndërhyrje kryesore në këtë gjykim, me cilësinë e palës së tretë, duke parashtruar (në mënyrë të përmbledhur) detyrimin civil që ka shoqëria “xxxx” ndaj saj.

Gjykata, bazuar në nenet 189 e vijues të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 3 të Ligjit nr.10192 konkludoi se kërkesa e paraqitur duhej të rrëzohej si e pambështetur në ligj, me arsyetimin se Ligji nr.10192/2009 "Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar, Trafikimit dhe Korrupsionit Nëpërmjet Masave Parandaluese Kundër Pasurisë", ka për objekt përcaktimin e procedurave, kompetencave dhe kriterëve për zbatimin e masave parandaluese kundër pasurisë së personave, që janë subjekt i këtij ligji, si të dyshuar për pjesëmarrje në krimin e organizuar dhe trafikim dhe, së fundmi edhe korrupsion.

Qëllimi i këtij ligji është parandalimi dhe goditja ndaj krimit të organizuar dhe trafikimit, përmes konfiskimit të pasurisë së personave, të cilët kanë një nivel të pajustificuar ekonomik, si rezultat i veprimtarisë së dyshuar kriminale.

Neni 22 pika 1) e ligjit aktual nr.10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar me ligjin nr.70/2017, parashikon se *“Gjatë gjykimit të kërkesës për konfiskim zbatohen, për aq sa është e mundur, dispozitat e Kodit të procedurës Penale”*.

Në referim të datës së rregjistrimit të kërkesës për konfiskim, objekt gjykimi (datë 02.05.2017) si edhe pikës 1) të dispozitave kalimtare të ligjit nr.70/2017, sipas të cilës *“ Ky ligj zbatohet për kërkesat e marrjes së masave parandaluese të paraqitura nga prokurori në gjykatën kompetente, pas hyrjes në fuqi të tij”*, Gjykata sqaron dhe vë në dukje faktin se gjatë gjykimit të kësaj kërkesë, zbatohen për aq sa është e mundur dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, pra siç ka qënë **para ndryshimeve të pësuara në Ligjin e Posaçëm nr.10192, datë 03.12.2009, me Ligjin nr.70/2017 i cili ka hyrë në fuqi më dt.20.06.2017.**

Neni 189 i Kodit të Procedurës Civile, parashikon: *“Kushdo mund të ndërhyjë në një proces gjyqësor që zhvillohet ndërmjet personave të tjerë, kur pretendon për vete tërësisht ose pjesërisht sendin ose një të drejtë që është objekt i padisë në shqyrtim, ose që lidhet me përfundimin e gjykimit, duke ngritur padi kundër të dy palëve ose njëerës prej tyre.*

Referuar nenit 3 të ligjit nr.10192, datë 03.12.20109” shoqëria “xxxx” “xxxx” sh.p.k, **nuk konsiderohet nga gjykata si person juridik i lidhur me pasurinë që kërkohet të konfiskohet nga paditësi**, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Shoqëria e sipërcituar, pretendon në gjykatë **realizimin e një të drejte civile, që rregullohet nga dispozitat e Kodit Civil**, ndërkohë ligji i posaçëm që trajton pasuritë e dyshuara si produkt i veprës penale, në asnjë dispozitë të tij nuk e autorizon gjykatën për të rregulluar një marrëdhënie juridike civile të lindur midis subjekteve të së drejtës civile.

Gjykata, në vijim evidenton faktin se referuar edhe nenit 26 të Ligjit të Posaçëm, disponon vetëm në dy mënyra, në konfiskimin e pasurive kur ato janë sipas rasteve të parashikuara në ligj apo, rrezimin e kërkesës për konfiskim, kur rezulton e kundërta.

III. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, më **datë xxxx** ka **filluar procedimin pasuror nr.xxx**, sipas ligjit nr.10192, dt.3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” (në vijim ligji nr.10192/2009) ndaj shtetasve F. K., M. Ç. dhe F. K., (dy të fundit si persona të lidhur, me shtetasin F. K.).

Ky procedim pasuror ka filluar mbi bazë të dokumentacionit të përcjellë nga Drejtoria e Policisë së Qarkut xxxx (emërtimi i asaj kohe, sot Drejtoria Vendore e Policisë xxxx) e cila me shkresën e saj nr.xxxx prot., datë xxxx, kërkonte verifikim pasuror të shtetasit F. K. për arsye se autoritetet gjyqësore italiane kishin kërkuar ekstradimin e tij.

Më datë xxxx policia gjyqësore e Drejtorisë së Policisë Qarkut xxxx ka kryer arrestimin e shtetasit F. K., i biri i S. dhe i Sh., i datëlindjes xxxx, lindur në xxxx dhe banues ne xxxx, i divorcuar prej datës 12.02.2017, me qëllim ekstradimin e tij nga Shqipëria në Itali, pasi Gjykata Penale e Romës, Itali me vendimin e saj, nr.xxxx- xxxx datë xxxx, e ka deklaruar fajtor për veprat penale “Shoqatë kriminale, trafikim, prodhim dhe posedim të lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope” dhe dënuar me xx vjet burgim.

Gjykata Penale e Milanos, Itali, me vendimin nr. xxxx.- xxxx, datë xxxx e ka deklaruar fajtor për veprën penale “Pjesëmarrje në organizatë kriminale dhe shkelje e ligjit për lëndët narkotike” dhe dënuar me xx vjet burgim.

Rezulton se në emër të shtetasve M. Ç. dhe F. K., (të cilët rezultojnë përkatësisht ish-bashkëshortja dhe djali i shtetasit F. K., sipas çertifikatave familjare të gjendjes civile, çertifikatë personale e shtetasit F. K., figurojnë të rregjistruara disa pasuri të cilat në referim të kontratave noteriale, **rezultojnë të fituara nga viti xxxx e në vijim**, konkretisht pasuritë e paluajtshme të listuara hollësisht si në pjesën hyrëse të këtij vendimi.(më poshtë do të pasqyrojmë hollësisht edhe origjinën si edhe mënyrën e fitimit të tyre)

Me vendimin nr.xx, datë xxxx të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, mbi kërkesën e paditësit, është vendosur si masë parandaluese, sekuestrimi ndaj të njëjtave pasuri, bazuar në nenin 11 të Ligjit Nr.10192/2009, në funksion të hetimit pasuror të filluar sipas këtij ligji.

III. Sipas palës paditëse, ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se shtetasi F. K. ka kryer krimin e pjesëmarrjes dhe në organizata kriminale për shkelje të ligjit për lëndët narkotike e cila në referim të nenit 3/1 të ligjit Nr. 10192/2009 dhe për këtë shtetas dhe shtetasit e tjerë të lidhur me të, sipas nenit 3/1 dhe 3/2 të këtij ligji, konkretisht ish bashkëshortja dhe djali i tij, duhet të aplikohen masat e parashikuara nga ky ligj për pasuritë e tyre.

Nga verifikimet e kryera si edhe nga provat e paraqitura në gjykim, me të ardhurat e shtetasve F. K., M. Ç. dhe F. K. sipas prokurorisë, nuk rezultojnë të ardhura të ligjshme që të justifikojnë vlerën e pasurive të mësipërme. Me kërkesën objekt gjykimi, Prokuroria për Krime të Rënda, Tiranë, bazuar në nenet 3, 5, 7, 22 e vijues të Ligjit Nr.10192/2009 ka kërkuar në gjykatë konfiskimin e pasurive të sipërpërmenduar, duke parashtruar (në mënyrë të përmbledhur) si më poshtë:

- ekzistojnë të gjitha kushtet ligjore për konfiskimin e pasurive të luajtshme/te paluajtshme që rezultojnë në emer të tre subjekteve hetimor dhe konkretisht :

Shtetasi F. K. është subjekt i ligjit nr.10192, date 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” sepse ekziston përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se është i përfshirë në veprimtari kriminale për pjesëmarrje dhe në organizata kriminale për shkelje të ligjit për lëndët narkotike (neni 3/1/a), rezulton të jetë i denuar nga Gjykata e Apelit Rome për veprën penale të “Posedim, prodhim dhe trafikim të lendeve narkotike”, veprë kjo e kryer në periudhën xxxx dhe xxxx, e përfshirë në listën e veprave penale të nenit 3/1/Ç të ligjit antimafia (neni 283 apo 283/a i Kodit Penal).

Përfshirja e shtetasit F. K. në veprimtaritë kriminale përkon me një kohë më të hershme se vënia në zotërim prej tij e pasurive (xxxx), objekt konfiskimi, megjithatë jo të gjitha në mënyrë formale (neni 3, pika 4).

Dyshimet për përfshirje në organizata kriminale të shtetasit F. K. fillojnë që në Gusht të vitit xxxx konkretisht kërkesa për arrestimin në nivel ndërkombëtar të shtetasit F. K. (e transmetuar nga xxxx leshuar me date xxxx, në vijim të njoftimit me të njëjtin numer të 11 shtatorit xxxx për ekzekutimin e mandat arrestit nr.xxxxx të Gjykatës së Milanos/Itali, leshuar me date 18 shtator xxxx, për shkelje të ligjit për narkotiket) per faktin se në Milano dhe Sesto San Govani (Milano/IT), ndërkohe që të gjitha pasuritë e krijuara prej tij dhe familjareve i përkasin një periudhe më të vonë (Dhjetor 1998, 2004, 2010, 2011).

Të paditurit M. C. dhe F. K., në emër të të cilëve rezultojnë pasuritë, objekt konfiskimi, përfshihen në rrethin e subjekteve, mbi pasuritë e të cilëve shtrihen dispozitat e ligjit antimafia. Shtetasi F. K. rezulton të jetë i biri i shtetasit F. K., ndërsa shtetësja M. Ç., ish-bashkëshortja e shtetasit F. K. deri me date xxxx, date në të cilën ka marrë formë të prare vendimi i zgjidhjes së martesës, vlerësohet se kualifikohet jo në personat e afërt në kuptim të pikës 2/a të ligjit, por në personat fizikë për të cilat ka të dhëna bindëse se pasuritë apo veprimtaritë e tyre megjithatë jo nga pikëpamja formale, zotërohen plotësisht apo pjesërisht, në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë nga personi mbi të cilin rëndon dyshimi se është i përfshirë në kryerjen e veprave penale të cituara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit, i padituri F. K..

Sipas palës paditëse, me shkresën date xxxx të Drejtorise se Policise Qarkut xxxx jepet informacioni se shtetasi F. K. nuk është i divorcuar asnjehere pasi bashkejeton me ish-bashkeshorten M. C. edhe pas dates xxxx (zgjidhja e martesës); Çertifikata familjare dhe personale e subjektit hetimor F. K. ku vërtetohet lindja e vajzes F. K. me date xxxx, dy muaj pas zgjidhjes se martesës; informacioni i IEVP-se xxxx ku vërtetohet se subjekti hetimor F. K. vazhdon të ketë takime intesive, në kuadër të takimeve familjare, me M. Ç..

Me provat e sipërcituara, sipas palës paditëse vërtetohet fakti i vijimit të bashkëjetesës së shtetasit F. K. dhe shtetases M. Ç. edhe pas vendimit gjyqësor që i ka dhënë fund ligjërimit martesës së tyre, pra zgjidhja e martesës ka qenë formale me qëllimin e vetëm, që të bëjë të mundur tjetërsimin e pasurive në emër të tij, drejt ish-bashkëshortes dhe personave të tjerë në vijim.

Sipas palës paditëse, veprimi juridik i shitblerjes se ish-parkut të industrisë, xxxx m2 truall+xxx m2 ndertim, ndermjet të paditurve F. K. dhe M. Ç., kjo e fundit blerëse (kontrata e shitjes nr.xxxx rep. nr. xxxx kol. date xxxx), është një veprim juridik fiktiv (jo për shkak të formes ligjore, por përmbajtjes – vullnet i paleve i vesuar), me qëllim humbjen e origjines se pronës dhe tjetërsimin e saj sepse: shitja e kësaj prone është bërë x muaj pas zgjidhjes se martesës (date xxxx). Nga kartela e pasurisë së pronës rezulton se blerja e kësaj prone është bërë nga subjekti F. K. gjatë martesës (xxxx), pavarësisht rregjistrimit në ZRPP vetëm në emër të tij. Si e tillë prona konsiderohet në bashkëpronësi të dy bashkëshorteve (rregjimi juridik ligjor); pas zgjidhjes së martesës së të paditurve F. dhe M., nuk është bërë pjestimi i pasurisë bashkëshortore, çka do të thotë se referuar prezumimit që sendet e fituara gjatë martesës iu perkasin bashkëshortëve në pjesë të barabarta, rezulton që blerësja të ketë blerë nga (ish) bashkëshorti dhe pjesën e saj; kjo pronë është vendosur kolateral për shlyerje kredie në shumën xxx mijë euro total, nga kredimarrësi xxxx sh.p.k, ku dorëzanës është subjekti F. K.. Pra subjekti M. Ç. jo vetëm që blen pasurinë e saj por vlen të përmendet që e blen një pasuri me barrë siç është hipoteka.

Konkretisht me deklaratën noteriale nr.xxxx Rep, nr.xxxx Kol, datë xxxx shoqëria “xxxx Bank” Sh.A e përfaqësuar nga drejtori i Degës xxxx, me anë të disa kontratave huaje (*kontratë huaje afatmesëm xxxx datë xxxx nr.xxxx Rep, nr.xxxx Kol, me kontratë huaje afatgjatë xxxx datë xxxx me marrëveshje për dhënie kredie në një llogari huaje xxxx dhe në marrëveshjen për dhënie kredie në një llogari huaje xxxx datë xxxx nr.xxxx rep, nr.xxxx kol me marrëveshje për dhënie kredie në një llogari huaje xxxx datë xxxx, nr.xxxx repo dhe nr.xxxx Kol, si dhe me kontratë huaje afatmesme xxxx*) i ka akorduar kredimarrësisht “xxxx” sh.p.k një kredi në shumën totale prej xxxx euro (xxxx euro) nga të cilat: xxxx euro me një normë interesi euribor x mujor+x% minimumi x% në vit dhe xxxx euro me një normë interesi x mujor+x% minimumi xx% në vit. Me shkresën nr.xxxx Prot, date xxxx te xxxx Bank rezulton se subjekti “xxxx” shpk nuk ka kredi të pashlyera, kredite që subjekti ka patur janë mbyllura. Referuar bilanceve të shoqërisë ndër vite, të cilat pasqyrojnë fitime modeste, rezulton se objektivisht është e pamundur shlyerja e kësteve të kredisë nga ky subjekt, duke

krijuar bindjen se të ardhurat për shlyerjen e kredisë janë të pajustificuara e rrjedhin nga veprimtaria kriminale e subjektit F. K.; çmimi i shitjes se pronës prej xxxx lekë, është një çmim fiktiv, vlerë kjo e paperfillshme në krahasim me vlerën prej xxxx euro të përcaktuar nga eksperti vlerësues (Ing.E. A.) për vlerësimin e kësaj prone lënë si kolateral në vitin xxxx, apo me vlerën e pronës sipas ekspertizës gjatë hetimit paraprak (xxxx leke) si në momentin e blerjes nga subjekti xxxx ashtu dhe në momentin e blerjes nga ish-bashkëshortja, subjekti xxxx.

Pala paditëse evidenton dhe pranon në konkluzionin e saj përfundimtar faktin se për sa u përket pasurive të tjera, tokë, bujqësore apo joproduktive, janë fituar nga subjekti hetimor M. Ç. me anë të dhurimit që i kanë bërë shtetasit Q. D. etj, të cilët origjinën e fitimit të këtyre pasurive e kanë me vendim të Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave, ish-pronareve.

Sipas saj, mënyra e fitimit të pronësisë së këtyre pasurive, nëpërmjet një veprimi juridik sic është kontrata e dhurimit, e cila në fakt është një veprim i kryer me shkak të dhuruesit “mirënjohjen”, si dhe duke patur parasysh vlerën e tregut të sendit të dhuruar, të krijon dyshimin e arsyeshëm mbi fiktivitetin e këtij veprimi juridik dhe qëllimit se në thelb ish-bashkëshortët kanë synuar të fshehin një veprim tjetër juridik, siç është kontrata e shitblerjes, si një veprim juridik i dyanshëm, me detyrime të ndërsjellta ndërmjet palëve, shitës dhe blerës (pagimi i çmimit nga ana e blerëses).

Sipas palës paditëse, fiktiviteti i këtij veprimi juridik rezulton edhe për faktin se përfaqesuesi ligjor i Q. D. dhe të të bashkëpronareve të kompesuar, pranë Agjencisë Kombëtare të kthimit dhe Kompesimit të Pronave, ish-pronarëve ka qenë shtetasi F.K., ish-bashkeshorti i shtetasës M. Ç., përfaqesim ky i kryer gjatë martesës (prokura e posaçme nr.xxxx Rep, nr.xxx Kol, datë xxx), si dhe në një kohë të shkurtër, ndërmjet personave me dhe pa lidhje gjinie (Q. D. etj, R. P., F. C., P. K.). Mbi disa nga këto pasuri janë kryer disa transaksione juridike me qëllimin e vetëm për të tjetërsuar tek të tretët dhe për të humbur origjinën e tyre (siç janë personat e thirrur me cilësinë e personave të tretë R. P., E. M. dhe A. M., “xxxx” shpk).

Edhe çmimi i blerjes apo shitjes se këtyre pronave tek të tretët është fiktiv krahasuar me çmimin real të tregut në momentin e transaksionit juridik të vlerësuar nga eksperti vlerësues.

Sipas palës paditëse, referuar deshmisë se deshmitareve Q. D. etj, rezultoi hapur se subjekti F. K. ka qenë prezent dhe ka ndërhyrë tek pronarët për kryerjen e veprimit juridik të dhurimit të sipërfaqeve të tokës tek (ish) bashkeshortja M. C. në vitin xxxx, duke u prezantuar si bashkeshorte, një arsye tjetër kjo që vërteton vijimin e bashkëjetesës ndërmjet subjekteve hetimor dhe qëllimin e fshehtësisë së origjinës së pronave në emër të subjektit ndaj të cilit ka dyshime për përfshirje në veprimtari kriminale.

Lidhur me subjektin tregtar "xxxx" sh.p.k., kjo shoqëri është regjistruar po gjatë vijimit të martesës së shtetasit F. K., i cili figuron administrator i saj, si dhe ish-bashkeshortja e tij M.C. bashkëpronare në x % të kuotave, e cila në vijim rezulton ortakë e vetme. Kjo referuar kontratës së shitjes së kuotave nr.xxxx rep., dhe, nr.xxxx kol., datë xxxx (sërisht gjatë vijimit të martesës).

Gjithashtu rezulton se edhe për dy shoqëritë e tjera, “xxxx” sh.p.k apo pjesën që i takon

shtetasit F. K., në shoqërinë “xxxx”, sh.p.k, ka të dhëna që janë në zotërim të subjektit mbi të cilin rëndon dyshimi se është i përfshirë në kryerjen e veprave penale të cituara në pikën 1 të nenit 3, shtetasit F. K..

Sipas palës paditëse, pikërisht këto të dhëna të vlerësuara së bashku, krijojnë dyshim të mjaftueshëm që bashkeshortet K. janë kujdesur që të mos e kenë me statusin ligjor të bashkëshortëve duke synuar që zoterimi formal i pronave t’i kalojë shtetasës M. Ç. apo të birit F. K..

Sipas palës paditëse, pronat, objekt konfiskimi, megjithëse figurojnë formalisht në emër të personave të tjerë, (pika 2 e nenit 3), zotërohen nga subjekti F. K., edhe për faktin se vlera e këtyre pasurive nuk i përshtatet dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme të deklaruara nga subjektet hetimor, M. Ç. dhe F. K., për qellime fiskale, por dhe nivelit të të ardhurave të subjektit kryesor F. K..

Referuar bilanceve të shoqërive tregtare rezultojnë të ardhura shumë të pakta të deklaruara nga subjektet tregtare ku figuron pronare e vetme apo bashkëpronare M. Ç. sikurse dhe subjekti ku është bashkëpronarë F. K.. Nderkohe vlera e të gjithë pasurive, duke marrë në konsideratë dyshimin e arsyeshem mbi fiktivitetin e veprimit juridik të dhurimit në favor të shtetasës M. Ç. ka një shproporcion shumë të madh me të ardhurat e deklaruara për qëllime fiskale.

Pala paditëse duke iu referuar, ekspertimit vlerësues të pasurive të paluajtshme, të kryer gjatë hetimit pasuror nga eksperti vlerësues shoqëria “xxxx” sh.p.k parashton se: Pasuria truall dhe ndërtesë, me sipërfaqe truall $xxxx\ m^2$ dhe sipërfaqe ndërtimi $xxxx\ m^2$ ndodhet brenda vijes së verdhe të qytetit $xxxx$, pozicionuar në veri të qytetit, në bllokun e banimit; bazuar në informacionin e marrë, investigimet dhe matjet e bëra, vlera e pronës është $xxxx$ leke. ($xxxx$ leke ekspertiza gjykates); pasuria nr. $xxxx$ me nr. $xxxx$ regjistri hipotekor, datë $xxxx$, pyll me sipërfaqe totale $xxxx\ m^2$, ndodhet në afërsi të $xxxx$, në zonën e pyllëzuar “xxxx”, $xxxx$, me vendndodhje shumë të avantazhuar për shkak të afërsisë me rrugën dhe me plazhin; për pjesën ideale në bashkëpronësi të shtetasit M. C., x pjesë ideale, bazuar në informacionin e marrë, investigimet dhe matjet e bëra, vlera e pronës është $xxxx$ lekë. ($xxxx$ leke eksp gjykates); pronat (tokë pyll) janë përfituar me kontrata dhurimi;

-sipërfaqe totale e pronës së dhuruar është $xxxx\ m^2$; pronat e dhuruara ndodhen në zonën e $xxxx$, në afërsi të $xxxx$ në zonën e pyllëzuar në $xxxx$, $xxxx$ dhe $xxxx$, hyrja realizohet nga rruga “xxxx”; kjo pronë ndodhet në një zonë të avantazhuar për shkak të afërsisë me rrugën $xxxx$ si edhe afërsisë me plazhin.

Bazuar në informacionin e marrë, investigimet dhe matjet e bëra, vlera e pronës në total (e dhuruar) është $xxxx$ lekë.

Në total, vlera e pronave të paluajtshme është: $xxxx + xxxx + xxxx = \underline{xxxxx\ leke}$. ($xxxx$ lekë sipas ekspertizës në gjykatë).

Sipas palës paditëse, në gjykim, me kërkesë të palës së paditur, me qëllim për të ripërcaktuar vlerën e asetëve të krijuara (të luajtshme/te paluajtshme), për të vlerësuar gjendjen financiare të subjekteve hetimor (të ardhura, shpenzime dhe kursime) si dhe mundësinë e justifikimit të

krijimit të këtyre aseteve nga të ardhurat e krijuara, të deklaruara ligjërisht, gjykata ka vendosur kryerjen e ekspertimi të ri vlerësues të pasurive të paluajtshme dhe ekspertimin kontabël.

Nga analizimi i akteve të ekspertimit të ri vlerësues të pronave dhe kontabël, sipas pales paditëse, konstatohet se mendimi i eksperteve është i pabazuar në ligj/akte nënligjore dhe provat e këtij procesi gjyqësor pasi konkluzionet e arritura në keto akte ekspertimi nuk janë objektive, nuk pasqyrojnë në mënyrë të qartë e objektive vlerën e aseteve të krijuara, gjendjen financiare të subjekteve hetimor, mundesine e krijimit të këtyre aseteve mbi bazën e të ardhurave të realizuara, të deklaruara ligjërisht deri në vitin e krijimit të secilit aset.

Sipas ekspertimit të ri vlerësues të pronave të paluajtshme rezultoi se vlera e objektit, ndertese dhe truall, është xxxx lekë, një diferencë shumë e madhe në krahasim me vlerën e përcaktuar nga ekspertiza e kryer gjatë hetimit paraprak (xxxx leke).

Sipas palës paditëse, vlerësimi i pasurive të paluajtshme të kryer gjatë gjyqimit, nuk duhet të merret në konsideratë, për shkak të pasaktësive si më poshtë:

-Përcaktimi i vlerës së pronës në vitin xxxx, dhe jo në vitin xxxx. Nuk është detyrë e ekspertit vlerësues të pronave të bëjë vlerësimin e pronës duke dhënë mendime juridike mbi kohën e përlllogaritjes së vlerës së saj bazuar në kohën e kryerjes së veprimit juridik të shitblerjes së pronës në vitin xxxx, nderkohe që kjo përlllogaritje duhet të bëhet në vitin xxxx, si vit i kryerjes së transaksionit juridik të kryer mes ish-bashkeshortëve, me qëllim fshehjen e origjinës së saj. Kjo duke mbajtur parasysh edhe faktin që shpenzimet familjare të kryera nga subjektet hetimorë u llogariten nga viti xxxx dhe jo nga momenti i martesës së tyre apo nga momenti i krijimit të të ardhurave (xxxx);

-mungesa e bazës ligjore apo referencave në vlerësimin e kryer. Vlera e truallit prej xxx leke/m² sipas ekspertes nuk ka asnjë bazë ligjore apo reference në transaksione të ngjashme të kryera në të njëjtën kohë në zonat përreth dhe në çmimet e paguara për pronat të ngjashme. Ekspertja nuk evidenton vendndodhjen e pronave të ngjashme të marra për krahasim për vitin xxxx. Informacioni lidhur me këto pronat mungon. Nisur nga fakti që pronat ka akses në ndodhet afër rrugës dhe ndodhet në një zonë që ka patur zhvillim, vendndodhja është e rëndësishme në përcaktimin e vlerës së tregut edhe për vitin xxxx, se cilës i është referuar.

Vlera e tregut për ndërtesën e përcaktuar nga eksperti për vitin xxxx është shumë më e ulët se ajo e përcaktuara në VKM nr.214, datë 28.04.1999 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i banesave dhe, të koeficientit “K” për qytetin e Fierit”.

Në këtë VKM është përcaktuar se çmimi për m² për ndërtim është në vlerën xxxx leke/m², nderkohe që sipas llogaritjeve të ekspertes ky çmim është llogaritur xxxx leke/m².

Sipas ekspertes në përlllogaritjen e vlerës së pronës janë marrë parasysh kushtet kur është bërë blerja e pronës, ndërkohë që amortizimin dhe pamjen vizuale të saj e ka në kohën e tanishme, në një kohë kur objekti i ekspertimit është thënë prej saj vete nuk përfshin kryerjen e inspektimeve mbi strukturën dhe qëndrueshmërinë e pronës.

Pra siç shihet, sipas paditëses, ndryshimi midis vlerës së paraqitur nga eksperti dhe çmimit

referues të parashikuar ne aktin nenligjor eshte një diferencë e konsiderueshme, duke synuar ne kete menyre uljen e vlerës së pronës, objekt ekspertimi. Eksperti ul ndjeshëm sipërfaqen e ndërtimit nga xxxx m2 në xxx m2, në kundërshtim të hapur me aktet zyrtare që pasqyrojnë këtë sipërfaqe, kartela e pasurisë apo çertificata e pronësisë.

Gjithashtu sipas ekspertimit te ri vleresues te pronave te paluajtshme, paditësja pretendon se rezultoi se vlera totale e objektit, toke bujqesore apo inproduktive/pyll, (+ xxxx pas xxxx sip xxxx m2 x xxx lekë) eshte xxxx lekë, një diferencë shumë e madhe krahasuar me vlerën e përcaktuar nga ekspertiza e kryer gjatë hetimit pasuror (xxxx lekë);

-në lidhje me vlerësimin e pronave tokë bujqësore apo inproduktive/pyll ekspertiza ka këto pasaktësi: Eksperti ka ndryshuar vendndodhjen e sipërfaqeve të tokës, objekt ekspertimi, të cilat realisht ndodhen në fshatin xxxx dhe xxxx, duke i pozicionuar dhe vlerësuar ato si toka të ndodhura në fshatit xxxx; eksperti ka ndryshuar llojin dhe destinacionin e tokave (kryesisht me funksion bujqesor /inproduktive/pyll, te ndodhura në zona të avantazhuara, në afërsi apo dalje në det)) duke i vlerësuar ato si kripore, pa vlerë; vlera e tregut për sipërfaqet e tokës të përcaktuara nga eksperti janë shumë më të ulëta dhe në kundërshtim të hapur me çmimet referuese të përcaktuara në VKM nr.139, datë 13.02.2008 “Për miratimin e çmimit te trojeve te percaktuara ne hartat perkatese, per qarkun e xxxx etj” referuar vendndodhjes se pronave per fshatin xxxx xx/m2 apo për fshatin xxxx xx/m2, duke i ulur ne xxx/m2, xxxx/m2 apo xx /m2, me qellim kryesor uljen e vleres se saj; eksperti për të njëjtat prona, ngjitur me njera – tjetren, të ndodhura në të njëjtën zonë kadastrale, në fshatin xxxx aplikon dy çmime te ndryshme per vlerësimin e tyre here xxxx/m2, here xxxx/m2; eksperti mohoi pasurinë nr.xxxx ndodhur në xxxx me sipërfaqe xxxx m2, vlerën e së cilës e llogariti në seancë gjyqësore me një çmim prej xxxx/m2, në kundërshtim të hapur me çmimet referuese të VKM në fuqi.

Sipas palës paditëse, akt ekspertiza mbi të cilën mbështetet eksperti vlerësues i caktuar nga gjykata nuk qëndron dhe nuk duhet të mbahet parasysh, pasi jo vetëm që nuk përcakton në mënyrë objektive vlerën e pronave, por ka ulur ndjeshem vlerën e tyre në krahasim me vlerën e përllogaritur nga ekspertiza e kryer gjatë hetimit paraprak (ndertese+truall+toka =xxxx lekë).

Në lidhje me aktin e ekspertimit kontabël, duke e ballafaquar me provat e tjera të administruara në këtë proces gjyqësor arrihet në përfundimin se të ardhurat dhe shpenzimet e secilit subjekt hetimor nuk rezultojnë nga burime të qarta, objektive, të deklaruara, e ligjore.

Eksperti në përllogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve të subjekteve është bazuar edhe në hamendësime, në përllogaritje hipotetike dhe, prezumime të nxjerra nga te dhena statistikore te marra në shtetin shqiptar. Ai nuk ka përllogaritur shpenzimet familjare të subjekteve hetimore nga viti xxxx, viti i martesës deri në vitin xxxx viti i krijimit të asetit truall+ndertese; ka llogaritur dy herë si të ardhura tërheqjet nga llogaria e shoqërisë duke i konsideruar nje here si te ardhura individuale te subjekteve hetimor dhe nje here si te ardhura të shoqërisë; ka llogaritur si te ardhura tepricen e kredise, ndërkohë që kredia e marrë për llogari të shoqërisë “xxxx” sh.p.k është në një vlerë totale prej xxx mije euro, e cila është shlyer totalisht nga subjekti(shpenzim), pavarsisht paaftësisë paguese të saj, referuar bilanceve te shoqërisë “xxxx” sh.p.k; është llogaritur si e ardhur pagen e subjekteve

hetimor te deklaruar nga punedhënesi (të vetëpunësuar) dhe jo të vertetuar nga instituti i sigurimeve shoqërore; është llogaritur si të ardhur vlerën e përfituar nga shitja e pronave të paluajtshme, ndërkohë që nuk llogarit si shpenzim riblerjen e pronës nr.xxx nga subjekti M. Ç. shtetasit F. Ç. (kontrata e shitblerjes nr. Xxxx re, nr.xxxx kol datë xxxx, sip xxxx m2); është përlllogaritur vlera e aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të shoqërive tregtare, ndërkohë që nuk është objekt i punës së tij, detyrë kjo e papërfunduar nga eksperti vlerësues i pronave.

Sipas palës paditese, të ardhurat e deklaruar ndërmjet viteve të subjekteve hetimor janë shume me te uleta se sa vlere e shpenzimeve të kryera nga subjektet për blerjen e aseteve të krijuara ndër vite.

Sipas ekspertit kontabël, në total të ardhurat e krijuara nga subjektet hetimor nga viti xxxx deri në vitin xxxx janë xxxx lekë, ndërkohë që ka përlllogaritur shpenzimet nga viti xxxx - xxxx në shumën xxxx lekë për pasuri të paluajtshme dhe xxxx leke për shpenzime familjare (+vlere e pas xxx + shpenzimet familjare rreth xxxx lekë).

Në këtë mënyrë, shumën e shpenzimeve të pajustificuara për periudhën xxxx-xxxx është afro xxxx lekë. Referuar këtij konkluzioni rezultoi se raporti i të ardhurave të subjekteve hetimor me vlerën e aseteve të krijuara nuk justifikon blerjen dhe krijimin e tyre. Kjo mosperputhje, sipas paditëses, rezultoi akoma dhe më e madhe po të mbahen parasysh rezultatet e ekspertimit vlerësues të pronave të kryer gjatë hetimit paraprak.

Sipas paditësit, për të gjitha pasuritë e sekuestruara me vendimin nr.xx, datë xxxx të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, jemi përpara kushteve të konfiskimit, parashikuar nga neni 24 i ligjit 10192/2009.

Nga ana e palës paditëse, u paraqitën aktet bashkëngjitur kërkesës padisë që në fillim të këtij gjykimi në lidhje me identifikimin e pasurive që kërkohen të konfiskohen, aktet për ekstradim të paditurit F. K. së bashku me aktet e gjendjes civile në lidhje edhe me gjendjen civile të paditurit F. si edhe, aktin e ekspertimit vlerësues të kryer gjatë hetimit pasuror të kryer shoqëria "xxxx" sh.p.k. Në momentin e diskutimit përfundimtar u paraqit shkresa nr.xxx prot., datë xxxx të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, xxxx dhe nr.xxxx prot., datë xxxx Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, xxx për të provuar se zgjidhja e martesës ndërmjet të paditurve F. dhe M. është fiktive.

-Në gjykim, të paditurit M. C. dhe F. K., palët e treta R. P., E. M. dhe A. M., si dhe shoqëria "xxxx" shpk, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre prapsuan dhe pohuan :

I padituri F. K., nëpërmjet përfaqësuesit të tij, prapsoi dhe parashtroi (në mënyrë të përmbledhur) se pretendimet e palës paditëse nuk qëndrojnë, vijnë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, garanci themelore kjo e të drejtës së pronës private. Ligji nr.10192/2009, të pandryshueshëm me ligjin nr.70/2017, kushtëzon veprimin për pasuri të krijuara përpara hyrjes në fuqi të tij vetëm nëse ata janë vënë gjatë përfshirjes së të dyshuarit në veprimtari kriminale.

Ligji nr.10192/2009, bie ndesh me nenin 29/1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. I

padituri F. nuk ka shkelur asnjë dispozitë civile. Ai është ndëshkuar njëherë nga autoritetet gjyqësore italiane, vend ku dhe ka ndodhur ngjarja e cila e bën të kithët të drejtën për të qënë paditës, një autoritet gjyqësor shqiptar, Prokurorinë e Krimeve të Rënda. Dënimi që ka marrë nga autoritetet gjyqësore italiane, e bën gjë të gjykuar, rastin objekt konfiskimi dhe të pamundur për ti dhënë atij një ndëshkim të dytë. Sipas tij edhe mënyra se si prokuroria zbaton ligjin nr.10192/2009, shton antikushtetueshmërinë përkatëse.

I padituri F. K. nuk ka asnjë indicje tjetër, përveç dënimit në Itali, të njëjtë brenda vendit apo jashtë tij. Asnjë nga pasuritë që kërkohet të konfiskohen nuk është krijuar gjatë periudhës kohore të pretenduar si i përfshirë në aktivitet kriminal. Në pronësi të të paditurit F. K. është vetëm prova nr.1, e cila aktblerjen më të parë të saj e ka në vitin xxxx, pra para periudhës së pretenduar për aktivitet kriminal, e për pasojë ligji i sipërcituar e pengon konfiskimin e saj edhe, për shkak të vënies së saj para ligjit të vitit xxxx. Pasurite e tjera që kërkohet të konfiskohen nuk kanë asnje lidhje direkte apo indirekte me të paditurin F. K..

Aktet e ekspertimit të kryera gjatë gjykimit të çështjes, sipas të paditurit, janë të bazuara, sikurse edhe debati gjyqësor në lidhje me to, të realizuar në séance gjyqësore. Palët e treta dhe dëshmitaret e pyetur në seancë gjyqësore ndikuan në vertetimin tej cdo dyshimi të arsyeshëm të jo vetem të zoterimit të ligjshëm e unik prej të tretëve të pasurisë së përfutur në mënyrë të ligjshme por, edhe të ligjshmërisë së dhurimit e vullnetit të lirë përkatës, nga pronarë tek M. Ç.. Nga ana e tij nuk u paraqit ndonjë provë, duke u mjaftuar me provat e paraqitura nga pala paditëse.

Të paditurit M. Ç., F. K. dhe palët e treta “xxxx” shpk dhe R. P., nëpërmjet përfaqësueses së tyre, në pretendimet përfundimtare prapsuan dhe parashtruan (në mënyrë të përmbledhur) se gjykimi i kërkesës për konfiskim duhet të përfundojë maksimalisht brenda një viti referuar datës së rregjistrimit të kërkesës. E në rastin objekt gjykimi, ky afat ka kaluar.

Në lidhje edhe me themelin e çështjes, sipas tyre, nuk ata nuk janë subjekte të zbatimit të ligjit të sipërcituar dhe së dyti prokuroria ka gabuar në vlerësimet e saj në lidhje me pasuritë e vëna dhe burimin e ligjshëm të vënies së tyre.

Në lidhje me pretendimin e parë padia bie ndesh me nenin 3 të ligjit nr.10192/2009. Të gjitha pasuritë që kërkohen të konfiskohen asnjë prej tyre nuk është në emrin e të paditurit F. K.. E paditura është martuar me të paditur F. K. me xxxx dhe është divorcuar me datë xxxx. E paditura M. Ç. nuk është subjekt i ligjit për arsye se nuk është person i afërt sipas këtij ligji, dhe nuk ka përfituar asnjë pasuri prej tij qoftë edhe në formën e dhurimit; të gjitha veprimet e kalimit të pronësisë nga të tretet tek e paditura M. C. janë kryer nga persona që nuk janë subjekte të këtij ligji. Shumica prej të cilëve kanë qënë ish-pronarë dhe mënyra e fitimit të pronësisë e kanë sipas ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave, vendimit nr.xxx datë xxxx, çka tregon burimin e ligjshëm të këtyre pasurive. Nga ana e palës paditëse nuk është përcaktuar sa ka qënë shuma e përfituar nga i padituri F. K. gjatë aktivitetit të tij të paligjshëm.

Pasuria që kërkohet të konfiskohet nuk është pasuri e aktivitetit kriminal të askujt prej të paditurve dhe burimi i të ardhurave në vendosjen e kësaj pasurie është tërësisht i ligjshëm. Pasuria nr. 1 nuk duhet ti nënshtrohet konfiskimit pasi është pasuri e fituar më datë

xxxx në referim me kohën e ushtrimit të aktivitetit kriminal të të paditurit F., të pretenduar nga pala paditëse, fund i vitit xxxx deri në Mars xxxx.

Kontratat e dhurimit nuk janë fiktive. Jo vetëm në anën formale por, edhe në themel të tyre. Ato, prej disa vitesh, janë në përdorim, të të paditurve F. e M. Ç..

Akti i ekspertimit vlerësues, i kryer nga pala paditëse, gjate hetimit pasuror, të mos merret në konsideratë nga gjykata pasi nuk është bërë rakordimi i të ardhurave me shpenzimet, që është edhe thelbi i ligjit. Me anë të saj është kryer vetëm vlerësim i pasurive të paluajtshme, me vlerën aktuale të tregut dhe, jo në referencë me kohën e fitimit të pasurisë, siç edhe duhet të ishte bërë. Për më tepër që është i pasaktë edhe në përcaktimin e sipërfaqeve (rasti i pasurisë xxxx me sipërfaqe xxxx m2 sipas aktit të pronësisë, e cila nga eksperti është bërë xxxx m2.

Akti i ekspertimit i kryer gjatë gjykimit të çështjes ku dhe gjykata duhet të mbështetet në dhënien e vendimit të saj, është korrekt pasi është i bazuar në ligj. Konkluzioni i ekspertëve është i bazuar ne akte ligjore.

Palët e treta A. M. dhe E. M., nëpërmjet përfaqësuesit të tyre, pretenduan dhe prapsuan se (në mënyrë të përmbledhur) objekti i padisë nuk është i saktë nga ana e prokurorisë, pasi rezulton se është e një sipërfaqe më të vogël nga sa është në realitet. Nga ana e paditësit nuk u paraqit asnjë prove ku të manifestohej se i padituri F. k. është pronar i vërtetë i pasurisë që kërkohet të konfiskohet dhe që rezulton në emër të palëve të treta E. dhe A. M.. Nuk u provua me asnjë prove se çmimi i shitjes së pasurive tek të tretët është fiktiv. Akti i ekspertimit i kryer nga pala paditëse, nuk është real dhe i pabazuar ne ligj. Veprimet e pales paditëse cënojnë parimin e sigurisë juridike mbi të drejtat e fituara dhe si një standart kushtetues. Gjykata nuk duhet të cënojë interesat e palës së tretë të fituara me mirebesim, në mënyrë të ligjshme dhe që nuk kanë patur aspak si qëllim të mbulojnë veprime apo aktivitete të paligjshme të askujt duke përfshirë edhe të paditurin F. K..

IV. Në mbështetje të prapsimeve dhe pretendimeve të ngritura gjatë gjykimit të çështjes nga ana e tyre u paraqitën me cilësinë e provës aktet si me poshtë: Vërtetim i Gjykates se Rrethit xxxx date xxxx, nga përmbajtja e të cilit rezulton se në regjistrat e kësaj gjykate në daten xxxx me nr.regj.xxxx eshte regjistruar si person juridik Ndermarrja e Ndërtimit, xxxx; vendimi i gjyqtarit te vetëm i dates xxxx nr.xxxx, xxxx ne lidhje me zgjerimin ose pranimin e ortakevete rinj ne kete shoqeri nga ku dy ortaket themelues Sh. E. dhe F. K. kane pranuar si ortak shtetasin B. H.; vertetimi i Drejtorise Rajonale Tatimore xxxx i dates xxxx me nr.akti xxxx ku evidentohet ne faqen x te aktit, qarkullimi i realizuar i tatimpaguesit shoqeria e sipercituar nga vitet xxxx deri ne vitin xxxx; bilancet e shoqerise xxxx shpk te vulosura nga Drejtoria Rajonale Tatimore, xxxx për vitet xxxx ku shoqëria identifikohet me nr.nipti xxxx; vërtetimi i shoqeruar me 4 flete nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore xxxx date xxxx me nr.prot.xxxx per shoqerine xxxx në lidhje me periudhën e sigurimit xxxx-xxxx; kontrate shitblerje e Zyres se Noterisë, xxxx date xxxx me nr.rep.,xxxx dhe, nr.kol., xxxx, me palë kontrate tre ortakët e shoqërisë xxxx, me objekt kontrate shitje ndërtese me sipërfaqe ndërtimeve xxxx m2 ne vleren xxxx leke, shoqeruar me harte treguese dhe certificate

vertetim pronësie; kontratë noteriale nr.rep.xxxx nr.kol.xxxx dt xxxx shoqeruar me deklarate noteriale nr.regj.xxxx date xxxx; note transkriptimi date xxxx nr.regj.xxxx; note transkriptimi date xxxx nr.regj.xxxx; kontrate Shitblerje datë xxxx nr.regj.xxxx dhe nr.kol.xxxx shoqeruar me planimetri, shesh dhe skice; ekstrakti historik i shoqerise xxxx shpk me date regjistrimi xxxx me NIPT- xxxx, me objekt veprimtarie prodhim materiale ndërtimi etj (9 flete); vërtetimi i Drejtorisë Rajonale Tatimore, xxxx i dates xxxx nr.akti xxxx ku evidentohet ne faqen 1 te aktit qarkullimi i realizuar i tatimpaguesit shoqëria e sipercituar nga vitet xxxx deri ne vitin xxxx; bilancet e shoqërisë xxxx shpk të vulosuara nga Drejtoria Rajonale Tatimore, xxxx për vitet xxxx; vertetimi i shoqeruar me 3 flete nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, xxxx datë xxxx me nr.prot.xxxx per shoqerine xxxx ne lidhje me periudhën e sigurimit xxxx; vërtetimi i shoqeruar me 3 flete nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore xxx date xxxx me nr.prot.xxxx për shoqërinë xxxx ne lidhje me periudhen e sigurimit xxxx; kontrate huaje date xxxx menr.rep.xxxx dhe nr.kol.xxxx me palë Kredidhenes Banka xxxx dhe, kredimarrës shoqeria “xxxx” sh.p.k per shumen xxxx leke me destinacion financimin e nevojave per blerje dhe regjistrim të një toke bujqësore me sipërfaqe xxxx m2 vendndodhje xxxx, xxxx; kontrate huaje, datë xxxx me nr.rep.,xxxx dhe nr.kol.,xxxx, me palë kredidhënës: Banka xxxx, dhe kredimarrës shoqeria “xxxx” sh.p.k për shumën xxxx Euro me destinacion investim të pasurive të palujtëshme; kontrate huaje datë xxxx me nr.rep.,xxx dhe, nr.kol.,xxx, me pale Kredidhenes Banka xxxx, Kredimarrës shoqeria xxxx sh.p.k, për financimin e nevojave të shoqërisë per shumën

xxxx Euro; urdhër xhirimi nga llogaria e “xxxx” sh.p.k datë xxxx per llogari te Zyres se Regjistrimit xxxx në shumën xxxx leke për pagesën e tatimit për shitje sipas kontratës të datës xxxx për blerje pronë me sipërfaqe xx ha me palë shitëse A. H. dhe bleres M. C. dhe F. A.; urdher xhirimi nga llogaria e “xxxx” sh.p.k, datë xxxx, për llogari të Zyrës së Regjistrimit xxxx në shumën

xxxx lekë për pagesën e tatimit për shitje sipas kontratës të datës xxxx për blerje prone me sipërfaqe xxx ha me palë shitëse A. H. dhe blerës M. C. dhe R. P.; deklaratë noteriale e datës xxxx me nr.rep., xxxx dhe, nr.kol.,xxxx, midis shoqërive Banka xxxx dhe “xxxx” shpk ku është përshkruar kontratë e huasë nga viti xxxx deri ne vitin xxxx me këtë banke si dhe shumat përkatëse dhe interesat si dhe barra ipotekore qe është vendosur nga shoqëria, për llogari të kredisë. Po kështu kjo deklaratë është e shoqëruar me kontratën e shitblerjes nr.rep.xxxx dhe nr.kol.xxxx date xxxx me pale shitese F. K., me palë blerese M. C. dhe objekti kontratës “Shitblerje truall+ndertese” (është pikerisht pasuria ku e paditura M. C. si ortake e vetme e shoqerise “xxxx” sh.p.k për llogari të xxxx Bank për marrje kredie). Ky kalim pronësie është bërë pas divorcit të palëve, i kushtezuar nga insistimi i bankës për të garantuar kreditë e marra; kontrata e shitblerjes e datës xxxx nr.regj.,xxxx dhe, nr.kol., xxxx, me palë shitëse K. S. dhe blerës F. K., me objekt kontrate “Objekti Parku Industrial xxxx”; kontrata e ipotekës xxxx, nr.rep., xxxx dhe, nr.kol.xxxx, datë xxxx, ndërmjet ipotekueses M. C. dhe përfituese Banka xxxx; kontrate shitblerje nr.rep.,xxxx dhe, nr.kol.. xxxx, datë xxxx me pale shitëse A. H. dhe palë blerës M. C. dhe F. A. me objekt “Blerje toke xx ha”, me vlerë xxxx leke ku pjesa në sipërfaqe dhe vlerë është xxxx m2 të paditurës M.

C. dhe xxxx m2 bleresit shtetasit F. A. (e shoqëruar me vërtetim pronësie dhe hartë treguese); kontratë shitblerje nr.rep.xxxx dhe nr.kol. xxxx date xxxx me pale shitese A. H. dhe pale blerës M. C. dhe R. P. me objekt “Blerje toke xxxx m2”, me vlerë xxxx leke ne raportet xxxx m2 M. Ç. dhe

xxxx m2 bleresi R. P. (kjo eshte e shoqeruar me vertetim pronesie dhe harte treguese); kontrate shitblerje date xxxx menr.rep.xxxx dhe nr.kol.xxxx me pale shitese F. Ç. dhe bleres M. C. me objekt kontrate “Blerje toke xxxx m2” me vlere xxxx leke (e shoqëruar me vërtetim pronesie dhe hartë treguese); kontrate shitblerje datë xxxx me nr.rep.,xxxx dhe nr.kol.,xxxx me pale shitëse M. Ç. dhe blerese L. L. me objekt kontrate “Shitje te nje siperfaqe toke are xxxx m2” me vlerë xxxx lekë (e shoqëruar me vertetim pronesie dhe harte treguese); kontrate shitblerje datë xxxx me nr.rep.,xxxx dhe nr.kol.,xxxx me palë shitese M. Ç. dhe bleres L. L. dhe F. Ç.,me objekt kontrate shitje tenje siperfaqe toke are

xxxx m2 L. L., ndersa bleresit F. Ç. siperfaqen xxxx m2 me vleretotale

xxxx leke (kjo eshte shoqeruar me vertetim pronesie dhe harte treguese); kontrate dhurimi nr.rep.xxx dhe nr.kol.xxx date xxxx me palë dhurues F. D. etj, ndërsa pranuese dhurimi M. Ç. dhe K. M. me objekt “Kontratë dhurimi te disa pasurive te palujteshme sipas përshkrimit në kontratë; kontratë dhurimi me nr.rep.,xxx dhe nr.kol., xxx datë xxxx, me pale dhurues F. D. etj, ndersa pranuese dhurimi P. K. dhe R. P. me objekt kontrate dhurimi te disa pasurive te palujteshme sipas pershkrimit në kontratë; kontratë dhurimi nr.rep.,xxxx dhe, nr.kol.,xxxx datë xxxx me pale dhuruese M. C. ndërsa pranuese dhurimi R. P. me objekt kontrate dhurimi te disa pasurive te palujteshme sipas pershkrimit ne kontrate; kontrate shitbleje me nr.rep.xxxx dhe nr.kol.,xxxx datë, xxxx me pale shitese M. C. dhe pales blerese “xxxx” shpk,me objekt kontrate shitje e pasurive të palujtëshme (tokë pa fryt) xxxx m2 me vlere xxxx leke; kontratë shitblerje me nr.rep.xxxx nr.kol.xxxx date xxxx me pale shitese M. C. dhe palës blerëse “xxxx” sh.p.k, me objekt kontrate shitje e një siperfaqe toke pa fryt xxxx m2 me vlerë xxxx lekë; kontratë shitblerje me nr.rep.,xxxx dhe nr.kol.,xxxx date xxxx me pale shitese M. C. dhe pales blerese “xxxx” shpk, me objekt kontrate shitje e një sipërfaqe tokë pa fryt xxxx m2 me vlere xxxx leke; kontrate shitblerje me nr.rep.xxxx nr.kol.xxxx date xxxx me palë shitese M. C. dhe pale blerese “xxxx” sh.p.k, me objekt kontrate shitje e një siperfaqe toke pa fryt xxxx m2 me vlere xxxx leke; kontrate shitblerje nr.rep.xxxx dhe nr.kol. xxx date xxxx me shitës F. K. dhe blerës Y. L., me objekt kontrate apartament banimi, shoqëruar me çertificate pronësie dhe harte treguese (7 flete); ekstrakti historik i shoqerise xxxx shpk me datë regjistrimi xxxx me NIPT- xxxx, me objekt veprimtarie “pastrim dhe riciklim të mbetjeve urbane...”, shoqeruar me duplikatë për nxjerrje nga llogaria në datën xxxx nr.xx ne lidhje me kalimin nga llogaria e shoqërisë “xxxx” tek shoqëria “xxxx” sh.p.k me destinacion shlyerje detyrimi për blerje autobuzësh. Ky kreditim është bërë nga shoqëria “xxxx” sh.p.k tek “xxxx”. Ky përshkrim i marrjes së kësaj kredie dhe me destinacion blerje autobuzësh gjen pasqyrim ne dokumentin nxjerrje llogarie në datën xxxx (3 flete); vërtetimi i Drejtorise Rajonale Tatimore xxxx i dates xxx me nr.akti xxxx ku evidentohet ne faqen 2 te aktit qarkullimi i realizuar i tatimpaguesit shoqeria e sipercituar nga vitet xxxx deri ne vitin xxxx; bilancet e shoqërisë “xxxx” sh.p.k. për vitet xxxx; vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve

Shoqerore, xxxx, datë xxxx me nr.prot.xxxx për shoqërine “xxxx” në lidhje me periudhën e sigurimit xxxx; ekstrakti historik i shoqërisë “xxxx” sh.p.k. datë regjistrimi xxxx me nr.nipti xxxx, me objekt veprimtarie “shërbim në fushën e parkimit me pagesë të mjeteve motorrike në rrugë ...”; vërtetim i Drejtorisë Rajonale Tatimore, xxxx, nr.akti xxxx, datë xxxx ku evidentohet qarkullimi i realizuar i tatimpaguesit shoqëria “xxxx” nga vitet xxxx deri në vitin xxxx; bilancet e shoqërisë “xxxx” shpk të vulosuara nga Drejtoria Rajonale Tatimore xxxx për vitet xxxx; vërtetimi i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, xxxx, datë xxxx, me nr.xxx prot., për shoqërinë “xxxx” në lidhje me periudhën e sigurimit xxxx”; vërtetim i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve shoqerore xxxx në lidhje me periudhën e sigurimit të shtetasit F. K. për periudhën xxxx-xxxx që i perket dosjes xxxx; vërtetim i datës xxxx me nr.prot.xxxx për ndërprerjen e tarifës së parkimit nga Bashkia, xxxx, drejtuar shoqërisë “xxxx” shpk; kontrate shërbimi i dates xxxx me pale Bashkia xxxx dhe shoqëria “xxxx” (3 flete); nxjerrje llogarie nga xxxx Bank, Agjensia nr.x, xxxx ku pasqyrohen xhirimet e shumave që kanë të bëjnë me kontratat e shitblerjes nga M. C. dhe bleres shoqëria “xxxx” sh.p.k për periudhën xxxx-xxxx; nxjerrje llogarie me emërtimin “xxxx” Agjensia nr.x xxxx, ku pasqyrohen xhirimet e shumave që kanë të bëjnë me kontratat e shitblerjes nga e paditura M. Ç. dhe bleres shoqëria “xxxx” shpk (3 fletë); vendim penal Nr.xxxx, date xxxx i Gjykates se Shkalles se Pare xxxx, me të pandehur A. B., F. K., etj, akuzuar për veprën penale “Shpërdorim i detyres”, ku është vendosur: Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit F. K., etj. Me vendimin nr.xxxx, datë xxxx Gjykata e Apelit xxxx ka vendosur: Mospranimin e ankimit të Prokurorisë pranë Gjykates se Rrethit Gjyqësor, xxxx. Lenien në fuqi të vendimit nr.xxx, date xxxx të Gjykates Rrethit Gjyqësor, xxxx; vendim penal Nr.xxxx, date xxxx i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, xxxx; vendim penal Nr.xxxx, datë xxxx i Gjykatës se Rrethit Gjyqësor, xxxx; vendim penal Nr.xxxx, date xxxx i Gjykates se Rrethit Gjyqësor, xxxx; vendim penal Nr.xxxx, date xxxx i Gjykates se Rrethit Gjyqësor, xxxx; vendim penal Nr.xxxx, date xxxx i Gjykates se Rrethit Gjyqësor, xxxx; vendim penal Nr.xxxx, date xxxx i Gjykates se Rrethit Gjyqësor, xxxx; vendim penal Nr.xxxx, date xxxx i Gjykates se Rrethit Gjyqësor, xxxx; me të pandehur F. K., etj, akuzuar për veprën penale “Mashtrimi”, ku është vendosur: Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit F. K., etj. Me vendimin nr.xxx, datë xxxx Gjykata e Apelit, xxxx, ka vendosur: Lënien në fuqi të vendimit nr.xxx, datë xxxx të Gjykates së Rrethit Gjyqësor, xxxx; vendim penal Nr.xxxx, date xxxx i Gjykates se Rrethit Gjyqësor, xxxx me pale kerkues: xxxx, Person i interesuar: Prokuroria pranë Gjykates se Shkalles se Pare xxxx , me objekt : Ulje dënimi prej një viti, për efekt të zbatimit të ligjit nr.154/2015, dt 21.12.2015 “Per dhenie amnistie”, ku është vendosur: Pranimi i kërkesës së kerkuesit F. K.. Me vendimin nr.xxx, date xxxx Gjykata e Apelit, xxxx ka vendosur: Lënien në fuqi të vendimit nr.xxxx, datë xxxx të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, xxxx; vendim penal Nr.xxxx, date xxxx i Gjykates së Shkalles së Parë xxxx me palë kerkues: F. K., Person i interesuar: Prokuroria pranë Gjykates se Rrethit Gjyqësor, xxxx, etj, me objekt: “Për dhenie amnistie”, ku është vendosur: Pushimin e gjykimit të kërkesës penale; vendim penal

Nr.xxxx, date xxxx i Gjykates se Shkalles se Pare xxxx me pale kerkues: F. K., Person i interesuar: Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare xxxx, etj, me objekt: Ulje te mases se denimit si rezultat i aplikimit të Amnistisë, duke zbritur nga masa e denimit x vjet” etj, ku eshte vendosur: Rrezimi i kërkesës së kerkuesit F. K.; vendim penal nr.xxxx, datë xxxx i Gjykates se Shkalles se Pare xxx me pale kërkuess: F. K., me objekt: Shuarje te mases së sigurimit “arrest ne burg”, ku eshte vendosur: Rrëzimi i kërkesës së kërkuessit F. K.. Me vendimin nr.xxx, date xxxx Gjykata e Apelit xxxx ka vendosur: Lenien ne fuqi te vendimit nr.xxxx, datë xxxx të Gjykates se Rrethit Gjyqësor, xxxx. Me vendim nr.xxxx, date xxxx Gjykata e Lartë ka vendosur: Mospranimin e rekursit; vendim penal Nr. xxxx, date xxxx i Gjykates së Rrethit Gjyqësor, xxxx me pale kerkues: F. K., me objekt: zëvendësim të masës së sigurimit, ku është vendosur: Zëvendësimi i masës se sigurimit personal ndaj te arrestuarit F. K. nga “arrest ne burg”, me masen e sigurimit “detyrim per tu paraqitur ne policinë gjyqesore”. Me vendim nr.xxx, date xxxx, Gjykata e Apelit xxxx ka vendosur: Ndryshimin e vendimit nr.xxxx, date xxxx të Gjykatës se Rrethit Gjyqësor, xxxx në këtë menyre: Rrëzimin e kërkesës; vendim penal Nr.xxxx date xxxx i Gjykatës se Rrethit Gjyqësor, xxxx me palë kerkues: F. K., person i interesuar: Prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqësor, xxxx ,etj me objekt: “Dhënie Amnistie”, ku eshte vendosur:Pushimin e gjykimit te kerkeses penale; vendim penal Nr.xxxx, date xxxx i Gjykatës se Rrethit Gjyqësor, xxxx me palë kërkuess: F. K., Person i interesuar: Prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqësor, xxxx, etj me objekt: “Përfitim nga amnistia”, ku është vendosur: Të deklarojë të papranueshme kërkesën penale; vendim civil Nr.xxxx, date xxxx i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, xxxx me pale padites: F. K., palë e paditur: P. J., me objekt: “Lirim dorezim sendi”, ku është vendosur: Pranimi i padise. Me vendim nr.xxxx, date xxxx, Gjykata e Apelit, xxxx ka vendosur: Lenien ne fuqi te vendimit nr. xxxx, date xxxx te Gjykates se Shkalles se Pare xxxx; vendim civil Nr.xxxx, date xxxx i Gjykates se Rrethit Gjyqësor, xxxx me palë padites: M. K., pale e paditur: F. K., me objekt: “Zgjidhje martese”, ku eshte vendosur: Pranimi i padise; vendim civil Nr.xxxx, date xxxx i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, xxxx me palë kerkuese: A. A., me objekt: “Leshimin e deshmise se trashëgimisë për të ndjerin S. V., ku eshte vendosur: Pranimin e kerkeses; vendim civil Nr.xxxx, date xxxx i Gjykates se Shkalles se Pare xxxx me pale padites: A. R. etj, pale e paditur: A. H., me objekt: “Detyrimin e subjektit te paditur te njohe trashegimlensesit e paditesave bashkepronare me trashëgimlënësit e të paditurës A. H., etj”, ku është vendosur: Kthimin e padisë; vendim civil Nr.xxx, date xxxx i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, xxxx me palë: paditës A. R. etj, pale e paditur: A. H., me objekt: “Detyrimin e subjekteve të paditur te njohin trashegimlensesit e paditesave A. V., etj bashkepronare me trashegimlensesit e te paditures A. H., etj”, ku eshte vendosur: Kthimin e padisë; vendim civil datë xxxx i Gjykates se Shkalles se Pare xxxx me pale paditese:A. H., palë e paditur: Komuna xxxx, etj, me objekt: “Njohje pronar”, ku eshte vendosur: Pushimi i gjykimit të çështjes civile; vendim civil Nr.xxxx, date xxxx i Gjykates se Shkalles se Pare xxxx me pale kerkues: A. D., persona te trete: Komuna xxxx, A. H., etj, me objekt: “Vertetimin e faktit juridik te qenies”, ku eshte

vendosur: Pushimi i gjykimit te ceshtjes civile; vendim civil Nr.xxxx, date xxxx i Gjykates se Shkalles se Pare xxxx me pale padites: F. K., pale e paditur: F. R., me objekt: “Lirim dorezim sendi”, ku është vendosur: Pranimi i kërkesë padisë. Me vendimin nr.xxxx, date xxxx Gjykata e Apelit, xxxx, ka vendosur: Lënien ne fuqi te vendimit nr.xxxx, date xxxx të Gjykates se Rrethit Gjyqësor, xxxx; vendim civil Nr.xxxx, datë xxxx i Gjykates se Shkalles se Pare xxxx me palë paditës: F. K., palë e paditur: E. N., me objekt: “Lirim dorezim sendi”, ku eshte vendosur: Pranimi i kerkese padise. Me vendimin nr.xxxx, date xxxx Gjykata e Apelit, xxxx, ka vendosur: Lenien ne fuqi te vendimit nr.xxxx, date xxxx te Gjykates se Rrethit Gjyqësor, xxxx; vendim civil Nr.xxxx, date xxxx i Gjykates se Rrethit Gjyqësor, xxxx me pale padites: F. K., pale e paditur: F. K., me objekt: “Lirim dorezim sendi”, ku është vendosur: Pranimi i kërkesë padisë. Me vendimin nr.xxxx, date xxxx Gjykata e Apelit xxxx ka vendosur: Lenien ne fuqi te vendimit nr.xxxx, date xxxx te Gjykates se Rrethit Gjyqësor, xxxx; vendim civil Nr.xxxx , date xxxx i Gjykates se Rrethit Gjyqësor, xxxx me palë paditës: F. K., pale e paditur: Sh. H., me objekt: “Lirim dorezim sendi”, ku eshte vendosur: Pranimi i kerkese padise. Me vendimin nr.xx, date xxxx Gjykata e Apelit xxxx ka vendosur: Lenien ne fuqi te vendimit nr.xxxx, date xxxx te Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, xxxx; vendim civil Nr. xxxx, date xxxx i Gjykates se Shkalles se Pare xxxx me pale padites: F. K., pale e paditur: Xh. M., etj, me objekt: “Lirim dorezim sendi”, ku eshte vendosur: Pranimi i kerkese padise. Me vendimin nr.xxxx, date xxxx Gjykata e Apelit xxxx ka vendosur: Lenien ne fuqi te vendimit nr.xxxx, datë xxxx te Gjykates se Shkalles se Pare xxxx; vendim civil Nr. xxxx, date xxxx i Gjykates se Rrethit Gjyqësor, xxxx me pale padites: F. K., pale e paditur: A. F., etj, me objekt: “Lirim dorezim sendi”, ku eshte vendosur: Pranimi i kërkesë padisë. Me vendimin nr.xxxx, date xxxx Gjykata e Apelit xxxx ka vendosur: Lenien ne fuqi te vendimit nr.xxxx, date xxxx te Gjykates se Rrethit Gjyqësor, xxxx; vendim civil Nr. xxxx, date xxxx i Gjykates se Shkalles se Pare xxxx me palë padites: F. K., pale e paditur: H. S., me objekt: “Lirim dorezim sendi”, ku është vendosur: Pushimi i gjykimit te çështjes civile; vendim civil Nr. xxxx, date xxxx i Gjykates se Shkalles se Pare xxxx me pale padites: F. K., pale e paditur: S. N., me objekt: “Lirim dorezim sendi”, ku eshte vendosur: Pranimin e padise. Me vendimin nr.xxx, date xxxx Gjykata e Apelit xxxx ka vendosur: Ndryshimin e vendimit nr.xxxx, date xxxx, të Gjykatës se Rrethit Gjyqësor, xxxx si më poshtë: Rrëzimin e padisë se paditesit F. K. palë e paditur S. N. , me objekt: Lirim dorezim sendi si te pa mbeshtetur ne prova dhe ne ligj; vendim civil Nr. xxxx, date xxxx i Gjykates se Rrethit Gjyqësor, xxxx me palë paditës: F. K., palë e paditur: E. F., etj, me objekt: “Lirim dorëzim sendi”, ku është vendosur: Pranimi i kërkesë padisë. Me vendimin nr.xx, date xxxx Gjykata e Apelit xxxx ka vendosur: Lënien ne fuqi të vendimit nr.xxxx, date xxxx të Gjykates se Rrethit Gjyqësor, xxxx. Me vendim nr. xxxx date xxxx, Kolegji Civil i Gjykates se Larte ka vendosur: Mospranimin e rekursit të paraqitur nga të paditurit; vendim civil Nr.xxx, date xxxx i Gjykates se Rrethit Gjyqësor, xxxx me palë padites: D. N., etj, pale e paditur: F. K. etj, me objekt: “Kundershtim të vendimit nr.xxx, date xxxx te Komisionit te Kthimit, etj”, ku është vendosur: Rrezimin e padise. Me vendimin nr.xxx, date xxxx Gjykata e Apelit xxxx

ka vendosur: Rrezimin e padise se paditesave. Me vendim nr.xxx, date xxxx, Gjykata e Larte Tirane ka vendosur: Mospranimin e rekursit te paraqitur nga paditesit. Me vendim nr.xxxx, date xxxx Gjykata e Larte ka vendosur: Mospranimin e kerkeses se paraqitur ne D. N., etj, per rishikimin e vendimit nr.xxxx, datë xxxx të Gjykatës së Lartë, të vendimit nr.xxxx, datë xxxx, të Gjykatës se Apelit, xxxx dhe vendimit nr. xxxx, date xxxx i Gjykates se Rrethit Gjyqësor xxxx; vendim civil Nr. xxxx, datë xxxx i Gjykates se Shkalles se Pare xxx me pale padites: A. H., pale e paditur: Agjensia e Kthimit dhe e Kompensimit te Pronave Zyra Rajonale e Qarkut xxxx, Ll. Gj., etj, me objekt: “Kundërshtim i vendimit te K.K.Pronave Bashkia xxxx nr.xxx, date xxxx ne favor të trashëgimtarëve të S. Gj.”, ku eshte vendosur: Pranimi i kerkese padise. Me vendimin nr.xxxx, datë xxxx Gjykata e Apelit xxxx ka vendosur: Prishjen e vendimit nr.xxxx, datë xxxx te Gjykates se Rrethit Gjyqësor xxxx; vendim civil Nr.xxxx, date xxxx i Gjykates se Rrethit Gjyqësor, xxxx me palë: paditës A. H., palë e paditur: Agjensia e Kthimit dhe e Kompensimit të Pronave xxxx, Th. V., etj, me objekt: “Kundërshtim i vendimit nr.x, date xxxx te K.K.Pronave Bashkia xxxx ne favor te trashëgimtareve të te ndjerit U. V.”, ku është vendosur: Te shpalle moskompetencen tokesore te Gjykates se Rrethit Gjyqësor, xxxx. Me vendimin nr.xxxx, date xxxx Gjykata e Larte Tirane ka vendosur: Prishjen e vendimit nr.xxxx, date xxxx të Gjykates se Rrethit Gjyqësor, xxxx dhe dergimin e ceshtjes per vazhdimin e gjykimit prane kesaj gjykate si gjykate kompetente; vendim civil Nr. xxxx, datë xxxx i Gjykates se Shkalles se Pare xxxx me pale kerkues: Gjykatën e Shkalles e Parë xxxx, me objekt: Ndreqjen e gabimit të vendimit civil me nr.xxxx, date xxxx ku eshte vendosur: Ndreqjen e gabimit në pjesën hyrëse të vendimit gjyqësor civil nr.xxxx, date xxxx, etj; vendim civil Nr. xxxx, date xxxx i Gjykates se Shkalles se Pare xxxx me pale padites: A. H., pale e paditur: Agjensia e Kthimit dhe Kompensimit te Pronave xxxx, etj, me objekt: “Anullim vendimi nr.xx, date xxxx te Komisionit te Kthimit te Pronave Qarku xxxx, etj”; vendim civil Nr.xxx, datë xxxx i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, xxxx me pale padites: A. D. etj, pale e paditur: A. H., me objekt: “Detyrimi per njohje bashkëpronar për prona që vijnë me trashëgimi ligjore e testamentare në masen xxx ha”, ku është vendosur: Te zgjidh çështjen me pajtim duke miratuar akt-marreveshjen; vendim civil Nr. xxxx, date xxxx i Gjykatës së Shkallës së Parë, xxxx me pale padites: A. H., palë e paditur: Agjensia e Trajtimit të Pronës Tiranë, Llamba Gjini etj, me objekt: “Kundërshtim i vendimit te Komisionit te Pronave te Qarkut xxxx”, etj, ku eshte vendosur: Të nxjerre jashte juridikisionit mosmarreveshjen civile; vendim civil nr. xxxx, date xxxx i Gjykates se Shkalles se Pare xxxx me pale kerkuese: A. H., me objekt: “Marrje mase sigurimi padie” ku eshte vendosur: Pranimi i kerkeses se kerkueses; vendim civil Nr. xxxx, date xxxx i Gjykates se Shkalles se Pare xxxx me pale padites: A. H., pale e paditur: Agjensia e Kthimit dhe Kompensimit te Pronave, Zyra Rajonale Qarku xxxx, Z. P., etj, me objekt: “Anullim vendimi nr.xxx, date xxxx te Komisionit te Kthimit te Pronave Qarku xxxx, etj” ku eshte vendosur: Pranimin e padise. Me vendimin nr.xxxx, date xxxx Gjykata e Apelit xxxx ka vendosur: Lenien ne fuqi te vendimit nr. xxxx, date xxxx te Gjykates se Shkalles se Pare xxxx. Me vendim nr.xxxx, date xxxx, Gjykata e Larte ka vendosur: Mospranimin e rekursit te paraqitur nga i padituri; vendim civil Nr.xxx, datë xxxx i Gjykatës se Shkalles së Parë xxxx me pale padites: F. K., palë e paditur: F. K., etj, me objekt: “Lirim dorezim sendi”; akt marreveshje xxxx Kol dhe nr.xxxx Kol, date xxxx; kontrate

shit-blerje me nr.xxxx rep dhe nr.xxxx kol, date xxxx, me pale shitese A. H. dhe pale blerese M. C., R. P., me objekt shitjen e pasurise se fituar nga pala shitese me trashegimi ne pjese te pandara pasurine me nr.xxxx e ndodhur ne ZK xxxx, ne fshatin xxxx etj; kontrate shit-blerje me nr.xxxx rep dhe nr.xxxx kol, date xxxx, me pales shitese M. C. dhe pale blerese L. L., me objekt: shitje e pjeses nga pasuria e paluajtshme cilesuar me vertetim hipotekor nr.xxx “toke inproduktive”, etj; Kontrate shitje me rezervë, me nr.xxxx rep dhe nr.xxxx kol, date xxxx, e lidhur midis K. M., F. K. dhe R. P., me objekt: premtimi per shitje e nje siperfaqje prej xx hektar ne total, etj; kontratë dhurimi nr.xxx rep dhe xxx kol, date xxxx me pale dhurues F. D., etj, pranues te dhurimit M. Ç., etj, me objekt: Dhurim pasuri të paluajtshme me xx m2 siperfaqje toke are, toke pyll dhe toke pa fryt, etj; kontrate dhurimi nr.xxx rep dhe xxx kol, date xxxx me pale dhurues F. D., etj, pranues te dhurimit R. P., etj, me objekt: Dhurim pasuri te paluajtshme i xx siperfaqeve toke are, toke pyll dhe toke pa fryt, etj; kontrate dhurimi nr.xxxx rep dhe xxx kol, date xxxx me palë dhuruese M. C., pranues te dhurimit R. P., me objekt: Dhurim pasuri te paluajtshme i x siperfaqeve toke pa fryt; deklarate Noteriale date xxxx me nr.xxxx regj dhe xxxx kol me deklaruese R. P.; vertetim hipotekor nr.xxx, date xxxx, pasuria me nr.xxxx ne ZK xxxx, me siperfaqje xxxx m2, me adrese te pasurise xxxx-xxxx, ne emer te R. P.; vertetim hipotekor nr.xxx, date xxxx, pasuria me nr.xxxx ne zonën kadastrale xxxx, me siperfaqje xxxx m2, me adresë të pasurisë xxxx, ne emer te R. P.; vertetim hipotekor nr.xxx, date xxxxx, pasuria me nr.xxxx në zonën kadastrale xxxx, me siperfaqje xxxx m2, me adrese te pasurise xxxx, në emër të R. P.; vertetim hipotekor nr.xxx, date xxxx, pasuria me nr.xxxx ne ZK xxxx, me siperfaqje xxxx m2, me adrese te pasurise xxxx, ne emer te R. P.; vertetim hipotekor nr.xxx, date xxxx, pasuria me nr.xxxx në zonën kadastrale xxxx, me siperfaqje xxxx m2, me adresë të pasurise xxxx, në emër të R. P.; vërtetim hipotekor nr.xxx, date xxxx, pasuria me nr.xxxx në zonën kadastrale xxx, me sipërfaqje xxxx m2, me adrese te pasurise xxxx, ne emer të R. P.; vertetim hipotekor nr.xxx, date xxxx pasuria me nr.xxxx ne ZK xxxx, me sipërfaqje xxxx m2, me adresë të pasurise xxxx, në emër të R. P.; vertetim hipotekor nr.xxx, datë xxxx, pasuria me nr.xxxx ne ZK xxxx, me sipërfaqje xxxx m2, me adresë të pasurisë xxxx, në emër të R. P.; faturat tatimore te perfaqesimit ne gjykime te ndryshme ne emer te F. k. të R. P. sikurse janë: fatura nr. x, e datës xxxx; fatura nr. x, e datës xxxx; fatura nr. x, e datës xxxx; fatura nr. xx, e datës xxxx; fatura nr. xx, e datës xxxx; faturat e shitjes nga “xxxx” sh.p.k për firmën “xx” sh.p.k për punimet e kryera për vitin (xxxx) datë xxxx; ekstrakt historik i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “shoqëri me përgjegjësi të kufizuara pranë QKB; ekstrakti historik i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “shoqëri me përgjegjësi të kufizuara pranë QKB; vërtetim njësia me origjinalin nr xxxx rep., datë xxxx; Kontratë shitblerje pasuri e paluajtshme datë xxxx, nr.xxxx kol., dhe nr,xxx rep..

Gjithashtu me kërkesë të të paditurve, u morën me cilësinë e provës “dëshmi” si më

poshtë: **Në seancë gjyqësore dëshmitarja A. P.**, me detyrë notere, e Dhomës së Noterisë, xxxx që prej vitin xxxx, dëshmon ne seancë gjyqësore se “...shtetasit F. K. dhe M. Ç., ... i njoh dhe kanë kryer veprime juridike pranë zyrës time, kanë kryer shumë veprime. Ata kanë ardhur me sa di, para dy ose tre javësh kanë kërkuar kopje të kontratës dhe ia kam dhënë. Sot kam edhe origjinalin me vete. Është e njëjta kontratë dhe e kam bërë unë, po është e njëjta me këto ekstremitete të cituara nga prokurorja. Është edhe kontrata e vitit xxxx dhe ka një deklaratë mbrapa që ajo është anuluar dhe është bërë përsëri në vitin xxxx...Anullimi është bërë me deklaram pranë zyres time, deklarate me palet, anullojne te paren gjithmone pa u rregjistruar ne hipoteke...Nuk e di me ç'farë është bërë me këtë objekt. Kontratën ne vitin xxxx, kanë ardhur palët dhe, e kanë bërë prapë në zyren time, këtë kontrate. Kontratat, janë pasqyruar në regjistrat e viteve xxxx dhe xxxx. Kam dhe fletët e rregjistrat që janë te rregjistruara...”.

Dëshmitarja M. M. banuese në xxxx, ne seancë gjyqësore deklaroi: “...Keni përfituar ndonjë pronë nga komisaioni i kthimit të pronave dhe nëse po në ç'farë vitesh?”

Nga komisioni I kthimit e kompensimit të pronave kemi përfituar pronë, por si vit nuk e kujtoj, viten kanë kaluar shumë. Shtetasen M. Ç. e njoh. Me M. kemi pasur miqësi dhe na ka ndihmuar për pronat, se ajo ishte në xxxx dhe ne në xxxx për këtë qëllim ia kemi lënë asaj në dorë të merret me nxjerrjen e dokumentave të pronave tona...meqënëse na ndihmuar i dhuruam diçka nga pjesa jonë. Dhurimin ia kemi dhënë dhe nuk kemi marrë leke për këtë gjë. Ne ia kemi dhuruar. Ne i dhuruam nga pjesa e tokës tonë, i dhuruam një pjesë toke dhe nuk e di nëse e kemi bërë me akt noterial, unë thjeshtë kam firmosur. Lidhje gjaku nuk kam me M.. Më rekomanduan për M., që do të interesohej për ne, për dokumentacionin e pronave. Kaq. Une nuk e kam njohur por e kanë njohur të tjerët dhe kemi shkuar me të njohur tek ajo. Na ka ndihmuar M. Ç. dhe i shoqi F. K..

Nuk e di dhe nuk kujtoj a i kemi dhene prokure, ka vite kjo pune, mua mi sillnin në shtëpi dhe i firmosja. Më ndihmoi për të marrë pronat. Unë u mora me të sepse ishte në xxxx dhe jemi bashkë me bashkëpronarët...”.

Dëshmitari Q. D., banues ne xxxx, ne séance gjyqësore dëshmon se “...Nga komisioni I kthimit dhe kompensimit të pronave kemi përfituar dhe na është kthyer në vitin xxxx, një sipërfaqe e madhe tokë dhe unë jam përfitues i kësaj toke. Pasi fituam tokën dhe rregjistruam këtë tokë, kemi bërë kalime pronësie. I kam bërë M. Ç., pasi e njihja dhe bashkëpunonim bashkë. Meqënëse sipërfaqja ishte shumë e madhe, në ishëm në xxxx, dhe nga ana ekonomike nuk kemi qënë mirë dhe nuk i ndiqnim dot, punën e pronave, menduam të caktojmë dikë që të merret me këtë punë. Na u duk përshtatshme M. dhe në vend të shpërblimit ia kemi lënë të merrej ajo me gjithcka ca kihste të bëntë me pronat, hartat, etj, kjo punë zgjati xx vite. Kontratat e dhurimit i kemi bërë tek një notere, dhe kemi bërë kontrate dhurimi, **nuk kemi marrë vlerë monetare.** Ja kemi dhenë tokën për shkak të punës që kishte bërë për ne. Në komisionin e Kthimit e Kompensimit të Pronave na ka përfaqësuar F. dhe M., kanë pasur akt noterial ka 20 vjet kjo pune, i kemi lëshuar prokure atyre. F. ka qënë anëtar i këshillit të qarkut, tani nuk e di... nuk kam lidhje lidhje tjeter me to. Unë, e dija që punonte aty, F. ka pasur prokurorë. të na përfaqësojë gjithkund ku kishte për të marrë dokumenta, do na përfaqësonte ai, harta etj.Edhe shpenzimet e benin ata vete, grupi I tyre, ka qënë kontrate shërbimi sepse nuk kishim para ne dhe, e vetmja arsye ishte kjo, nuk i ndiqnim dot dhe do merreshin këta me këtë punë...”.

Dëshmitari F. R. banues në xxxx, deklaroi se: “...Po, kam fituar me komisionin e kthimit të pronave, ka shumë vite që e kam fituar ne fshatin xxxx. E njoh M. C. e njoh dhe kemi nënshkruar një akt dhurimi vullnetar me të. E kemi bërë krejtësisht

falas, në bazë të një marëveshje shërbimi, në lidhje me marjen e kësaj prone, me interesim për këtë prone. M. është marrë me këtë praktikën dhe grumbullimin e dokumentacionit, më shume se dhjetë vjet, është marrë me këtë punë. Kur I kemi bere dhurimin nuk ka dhene asnjë lekë, ia kemi dhuruar me vullnet të plotë. Unë jam në një grup dhe unë jam pjestar, është motra ime dhe djemtë e xhaxhallarve, ia kemi dhënë pronën me vullnet të plotë. Në fillim nënshkruam një akt që të merrte përsipër F. K., që të na ndihmonte se ne ishim të paaftë për të ndjekur kthimin e pronës, se kishte edhe pretendime rreth tokave. U krijua një precedent që kërkonte një ndërhyrje të gjërë nga pikpamja juridike, në kërkua një njeri, pasi ishim në moshë, largësia ishte e madhe, makinë nuk kishim dhe për këtë u detyruam të bëjmë një gjë të tillë, pra të caktonim një njeri që të ndiqte këtë punë. Nuk e mbaj mend, se ku e kemi bërë, në noteri e kemi bërë por ku, nuk e di, ka me shumë se 12 vjet, ndoshta dhe më shumë. Nuk e njihnim dhe nuk e di kush na e rekomandoi. Në këtë mënyrë filloi kjo punë. Dokumentacionin e kemi firmosur, në shtepinë e nënës time, sepse ajo ishte e pafuqishme dhe ka ardhur edhe noterja dhe gjithë pjestarët pa përjashtim, ka qënë shume korrekte noterja, aty kemi firmosur të gjithë, për t'ja dhuruar M. Ç.. F. K. do interesohej siç thashë më lart, pastaj se kujt deshën tja jepnin këtë pjese ishte pune e tyre, ne na interesonte vetëm që të merrnin përsipër interesimin për këtë punë. F. përjashtojë veten nga kërkesa e tij për të qënë pjestar, dhe ne ishim të qetë se pervec M. nuk do kërkonte pjesë edhe F. për nje dhurim të tillë. M. për t'ë na ndihmuar neve duhet të ndiqeshin gjyqet, dokumentacionin plotesues, tek noteret, ajo bëri punen dhe ne na e ktheu pronën komisoni i kthimit të pronave. Kjo punë që u fut M. për të na ndihmuar ka zgjatur sigurisht, nuk mbaj mend sa vite, me shume se një vit dhe dhurimin e kam dhënë vullnetarisht. Qëllimi I këtij dhurimi ka qënë shërbimi, shërbimi që ka bërë ndaj nesh dhe i dhame dhurimin, per këtë shërbim....Përveç interesimit në komision të kthimit të pronave është interesuar M. Ç., ka kryer edhe ka pasur goxha punë, edhe gjyqe, dhe ka shkuar kudo e ka parë të nevojshme që të shkojë...”.

Me kërkesë të palëve të paditura dhe, provave të paraqitura prej tyre, gjykata ka vendosur kryerjen e një ekspertimi kontabël dhe vlerësues, në kushtet kur, ky akt ekspertimi nuk ishte kryer, pasi realizohet në gjykim dhe se **pala paditëse, Prokuroria për krime të Rënda, paraqiti si provë “dokument” të quajturin “akt ekspertimi vlerësues” që iu referohej vlerës së pasurive në treg dhe, jo kohës së kryer të transaksionit.**

Së bashku me ekspertimin vlerësues, gjykata me kërkesë po të palës paditëse kreu dhe një ekspertim kontabël për të llogaritur të ardhurat dhe shpenzimet në vite të të paditurve, shumat e mundshme të kursyera prej tyre dhe mundësinë e mbulimit të vlerës së pasurive objekt konfiskimi (kjo sipas vlerave të nxjera nga ekspertimi vlerësues i pasurive të paluajtshme). Shpenzimet e të paditurve, janë përlllogaritur nga eksperti kontabel në referim të të dhenave hipotetike, ne mungese te te dhenave statistikore.

V. Në lidhje me kërkesën objekt gjykimi, gjykata vlerëson sa më poshtë:

Lidhur me ligjin e aplikueshëm në çështjen objekt gjykimi, ligj material është Ligji Nr.10192, Datë 3.12.2009, para ndryshimeve të bëra me Ligjin Nr.70/2017 dhe, procedurat e gjykimit të tij përveç Ligjit të Posaçëm Parandalues rregullohen me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, të zbatuara nga kjo gjykatë në gjykimin e kësaj çështjeje.

Një vlerësim të tillë kjo gjykatë e mbështet në ligjin e posaçëm parandalues Nr.10192, Datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe

krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, që ka pësuar disa ndryshime dhe dispozitave kalimtare (nenit 38 e vijues) të Ligjit Nr.70/2017, i cili ka bërë ndryshimet e fundit të tij sipas të cilave, në këtë gjykim, për shkak të kohës së paraqitjes së kërkesës për marrjen e masave parandaluese (**data e sekuestros paraprake xxxx**) do të aplikohet Ligji Nr.10192, Datë 3.12.2009, ndryshuar me ligjin nr.24/2014 para ndryshimeve të fundit të tij (70/2017) dhe më poshtë do të referohet vetëm si Ligji Nr.10192/2009).

V.i) Ligji Nr.10192/2009, drejtohet kundër pasurisë të personave të dyshuar për përfshirje në veprimtaritë kriminale të përcaktuara saktësisht në këtë ligj, të cilat janë vepra penale të sferës së krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit dhe qëllimi i tij është që të parandalohet dhe të goditet ky lloj kriminaliteti me anë të masave parandaluese të marra ndaj pasurive të personave të dyshuar, ku më kryesorja është konfiskimi i tyre.

Në rastin objekt gjykimi, gjykata sqaron se Ligji Nr.10192/2009, referuar kohës së rregjistrimit të padisë (**datë xxxx**) dhe përfundimit të saj, (**datë xxxx**), neni 7 i Ligjit nr.10/192/2009, i cili ka pësuar ndryshime, përcakton gjykatën kompetente për shqyrtimin e masave parandaluese. Sikurse u tha dhe në paragrafin e mësipërm të këtij vendimi, **para ndryshimeve të pësuara së fundmi me ligjin nr.70/2017, gjykata kompetente ishte gjykata për krime të rënda**, e cila në rastin e sekuestrimit përbëhej nga një gjyqtar i vetëm ndërsa në **rastin e konfiskimit të pasurisë gjykonte në kolegji me tre gjyqtarë**. Tashmë me Ligjin Nr.70/2017, gjykata kompetente përcaktohet në bazë të kompetencës përkatëse lëndore për veprën penale të kryer, pra shqyrtohen nga gjykatat e rretheve gjyqësore ose gjykata e shkallës së parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, nga një gjyqtar i vetëm dhe, nga gjykata e Apelit ose Gjykata e Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë.

Gjithashtu, gjykata evidenton faktin se referuar përcaktimit shprehimisht të dispozitave kalimtare të Ligjit nr.70/2017, sipas të cilit (citoj) “*deri në krijimin e gjykatës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, çështjet për marrjen e masave parandaluese kundër pasurisë do të gjykohen nga gjykata për krime të rënda*”, **deri në krijimin e gjykatës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, çështjet për marrjen e masave parandaluese kundër pasurisë do të gjykohen nga gjykata për krime të rënda, e për pasojë kjo gjykatë e përbërë prej tre gjyqtarësh**, si në pjesën hyrëse të tij, gjen kompetencën e saj të gjyqimit.

V.ii) Për të vendosur konfiskimin e pasurisë të personit të dyshuar, bazuar në nenin 24/1 të ligjit të sipërcituar **duhet që të plotësohen njëkohësisht këto kushte**:

“i) kur ka dyshime të arsyeshme, bazuar në indicia për pjesëmarrjen e personit në veprimtari kriminale të parashikuara në nenin 3;

i) kur nuk provohet se pasuria ka prejardhje të ligjshme apo personi nuk justifikon zoterimin e pasurive ose të të ardhurave, që nuk i përgjigjen dukshëm nvelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara dhe as nuk justifikohen prej tyre;

ii) Kur rezulton se pasuria është drejtëpërdrejtë ose tërthorazi në zotërim të pjesshëm apo të plotë të personit” .

Bazuar në ligjin 21/3 të ligjit 10192/2009, **barra e provës për të vërtetuar se pasuritë janë fituar në mënyrë të ligjshme, i takon personit kundër të cilit kërkohet konfiskimi.**

Në rastin në gjykim, **shtetasi F. K.**, sipas të dhënave paraprake të marra nga autoritetet italiane siç u përmend më lart, **është personi i dyshuar për kryerjen e veprës penale sipas nenit 283/a, 333/a dhe 334 të Kodit Penal.** Në nenin 3/1, gërma “ç” e ligjit 10192/2009 parashikohet se:

“Dispozitat e këtij ligji zbatohen për pasuritë e personave, mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, bazuar në indicie, për:

...d) për kryerjen e krimeve të parashikuara nga nenet 283...të Kodit Penal.

Sipas kësaj dispozite, për vërtetimin e dyshimit të arsyeshëm për kryerjen e veprës penale është e mjaftueshme që shkalla e provueshmërisë të jetë në nivelin e indicjeve dhe duhet që të vërtetohet ekzistenca e më shumë se një indicjeje, që në rastin konkret **provohet pa asnjë dyshim që shtetasi F. K. është subjekt i ligjit të sipërcituar**, për shkak të dënimit të tij nga autoritetet gjyqësore italiane, për veprat penale të cilat parashikohen si të tilla sipas nenit 283/a, në lidhje me nenin 333/a të Kodit Penal shqiptar. Arsyetimi që parashtron përfaqësuesi i tij, sipas të cilit nuk mund të ndëshkohet dy herë dhe, se ndodhemi para gjësë së gjykuar, nuk qëndron dhe, vjen si rezultat i arsyetimit jo ligjor. Në rastin konkret, **dënimi penal, për faktet penale sipas neneve 283; 333/a të Kodit Penal shqiptar, passjell edhe verifikimin e pasurisë.**

Në lidhje me pretendimin se pasuritë nuk janë krijuar gjatë ushtrimit të aktivitetit kriminal, e për pasojë nuk duhet të konfiskohen, gjykata shprehet se ky pretendim nuk qëndron, pasi sipas Ligjit në tërësi Nr.10192/2009, verifikimi i pasurisë, për subjektet e procedimit pasuror, shtrihet për të gjithë pasurinë e vënë gjatë ushtrimit të aktivitetit kriminal e, në vijim. Nuk janë objekt i ligjit të sipërcituar dhe, subjekti i procedimit pasuror nuk ka detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e pasurive të vëna, para periudhës së provuar të aktivitetit kriminal.

Në rastin objekt, gjykimi, provohet se indicjet për fillimin e aktivitetit kriminal të të paditurit F. K., i përkasin periudhës nga 18 Gusht xxxx-xxxx, për pasojë, verifikimi pasuror do të shtrihet për të gjithë pasurinë e tij të vënë, pas kësaj periudhe.

IV.iii) Për shkak të lidhjes së afërt të personit të dyshuar F. K., me të paditurin F. K. (i biri) dhe të faktit se në emër të tij figurojnë pasuri, ky shtetas është subjekt i hetimit pasuror që përfshihen në rrethin e personave që parashikon neni 3/2 gërma “a” i Ligjit Nr.10192/2009 sipas të cilit:

“..

2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe ndaj pasurive të:

a) Personave të afërm (bashkëshorti, fëmijët, të paralindurit, të paslidurit, vëllezërit, motrat, ungjërit, emta, nipërit, mbesat fëmijët e vëllezërve dhe të motrave, vjehrrit, vjehrra, dhendri, nusja, kunata, kunati, bashkëjetuesi, thjeshtri, thjeshtra, njerku dhe njerka) të subjekteve të pikës 1 të këtij neni.

..”

Gjithashtu **edhe e paditura M. K., është subjekt i Ligjit Nr.10192/2009, sipas nenit 3 pika 2, gërma b)** sipas të cilës :

“Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe ndaj pasurive të:

Personave fizikë ose juridikë, për të cilët ka të dhëna të mjaftueshme se pasuritë ose veprimtaritë e tyre zotërohen pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë, kanë lehtësuar apo në një formë kanë ndikuar në kryerjen e veprimtarive të jashtëligjshme ligjshme nga personat e parashikuar në pikën 1 të këtij neni. ...”, pasi në këtë gjykim **u provua me të dhëna të mjaftueshme se pasuritë në emër të saj zotërohen në mënyrë të tërthortë nga i padituri F..**

Gjykata, evidenton dhe, vlerëson në këtë vendim edhe faktin se është detyrë e palës paditëse (Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë) që në kërkesën e saj për konfiskim të **argumentojë dhe provojë jo vetëm lidhjen e afërt të gjinisë me personat e dyshuar për veprat penale sipas pikës 1, por edhe të dhëna konkrete, mbi të cilat ngrihen dyshime të bazuara se pasuritë e këtyre personave të afërm u përkasin në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë personave të dyshuar për veprat penale sipas pikës 2 të nenit 3 të ligjit parandalues, siç edhe rezultoi.** Lidhur me personat e tjere te trete ne kete proces, në emër të të cilëve rezultojnë pasuri, objekt konfikimi të këtij gjykimi, **nuk u provua që ata të jenë subjekte të Ligjit Parandalues, në kuptim të nenit 3 të Ligjit Nr.10192/2009**, pasi që nga momenti i transaksionit të kryer prej tyre, nuk provohet që pasuritë të zotërohen në mënyrë të tërthortë apo të drejtëpërdrejtë nga i padituri F. K., siç Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, pretendoi por, nuk provoi në këtë gjykim.

Aq më tepër kur në rastin objekt gjykimi, disa prej pasurive që kërkohet të konfiskohen, janë në emër të personave të tretë pa lidhje gjinie ose, krushqie më të paditurin K. (R. P., E. M., A. M., shoqëria “xxxx” shpk), arsye për të cilën duhet një hetim i mirëfilltë, i detajuar duke pasur detyrimin gjykata të shpjegojë arsyet përse e quan fiktiv ndërftjen, arsye të cilat duhet të bazohen në elementet faktikë të konceptuara nga kërkesat e rëndësisë saktësisë dhe përputhjes së përshtatshme për të formuar provën indirekte të dyshimit të arsyeshëm për disponibilitetin e pasurisë nga i dyshuari F. K..

